



MANUALI I MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Për prindërit kujdestarë

UDHËZIME PËR KËTË MANUAL

HYRJE 1

PROGRAMI I MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN 4

Programi i mbështetjes financiare për fëmijën vë fëmijën në radhë të parë dhe pranon se të dy prindërit kanë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e fëmijëve të tyre. Mirëqenia e fëmijëve është më e mirë kur marrin ndihmë financiare dhe prindërim pozitiv nga të dy prindërit. Programi është i suksesshëm dhe efikas në përcaktimin e atësisë/mëmësisë, mbledhjen e të ardhurave të mbështetjes financiare për fëmijën dhe ekspozimin e prindërve jokujdestarë ndaj mundësive të punësimit.

Ky seksion në manual shpjegon:

- Regjistrimin në programin e mbështetjes financiare për fëmijën
- Gjetjen e vendndodhjes së prindit jokujdestar
- Përcaktimin e atësisë/mëmësisë
- Dërgimin e fletëthirrjes
- Dërgimin e çështjes në gjykatë
- Urdhrat e mbështetjes financiare dhe mjekësore për fëmijën
- Mbledhjen e pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën
- Ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën
- Ndryshimin e vlerës së urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën
- Shfuqizimin e urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën

DIVORCI DHE MBËSHTETJA FINANCIARE PËR FËMIJËN 15

Procesi i mbështetjes financiare për fëmijën është i ndryshëm për prindërit që po divorcohen dhe ata që janë të divorcuar.

KUJDESTARIA DHE VIZITAT 17

Kujdestaria dhe vizitat nuk diskutohen gjatë një seance gjyqësore të mbështetjes financiare për fëmijën. Kujdestaria dhe vizitat diskutohen në një proces të veçantë gjyqësor. Prindërit mund të diskutojnë për kujdestarinë dhe vizitat edhe duke përdorur një shërbim ndërmjetësimi.

DHUNA NË FAMILJE DHE MBËSHTETJA FINANCIARE PËR FËMIJËN 18

Disa aspekte të programit të mbështetjes financiare për fëmijën mund të nxisin dhunë në familje. Për të mësuar më shumë rreth programit dhe për të parë nëse është vendimi i duhur për ju, vizitoni <https://on.nyc.gov/child-support-safely>. Nëse jeni të shqetësuar për sigurinë tuaj ose të fëmijës, flisni me punonjësën sociale të fëmijës tuaj ose Specialistin për Mundësitë e Punësimit (JOS). Mund të përjashtoheni nga detyrimi për të paguar mbështetje financiare për fëmijën nëse merrni ndihmë ekonomike nga shteti. Programi i mbështetjes financiare për fëmijën dhe gjykata mund të vendosin masa mbrojtëse kundër dhunës në familje për të garantuar privatësinë e informacionit të rastit të mbështetjes financiare të fëmijës dhe sigurinë tuaj në gjykatë.

INFORMACION PËR NDIHMËN EKONOMIKE DHE NDIHMËN MJEKËSORE KLIENTË 20

Kërkohet që të bashkëpunoni me Zyrën e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën në mënyrë që të përfitonit ndihmë të plotë nga shteti për familjen tuaj.

Ky seksion në manual shpjegon:

- Dokumentet e nevojshme
- Bashkëpunimin me Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën
- Dërgimin e çështjes në gjykatë
- Kujdestaria
- Sa mbështetje financiare mund të merrni për fëmijën
- Marrja e mbështetjes financiare për fëmijën kur shkëputeni nga ndihma shtetërore

INFORMACIONI I KONTAKTIT I MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN 24

SHABLLON I URDRIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN 26

FJALORTH I TERMAVE TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN 28



HYRJE

Zyra e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (OCSS) punon me familjet e Nju Jorkut, pavarësisht të ardhurave të tyre apo statusit të emigracionit, për t'u siguruar që fëmijët të marrin mbështetje financiare nga të dy prindërit. OCSS-ja e ndihmon prindin kujdestar (prind, i afërm, ose kujdestar që jeton me një të mitur dhe është kujdestari parësor i tij) të kuptojë programin e mbështetjes financiare për fëmijën dhe ofron shërbime përgjatë të gjithë procesit. OCSS-ja e ndihmon prindin jokujdestar (prind që nuk jeton me të miturin dhe nuk është kujdestari parësor i tij) duke ofruar programe që e ndihmojnë atë të përmbushë detyrimet e tij lidhur me mbështetjen financiare të fëmijës dhe të menaxhojë rastet e mbështetjes financiare të fëmijës.

Programi i mbështetjes financiare për fëmijën nuk është i barasvlershëm me Gjykatën e Çështjeve Familjare. Edhe pse punojnë së bashku dhe kanë si qëllim të përbashkët përmirësimin e jetës së fëmijëve të qytetit të Nju Jorkut përmes programit zyrtar të mbështetjes financiare për fëmijën, ato janë dy organizata të ndryshme, me funksione të ndryshme.

OCSS-ja është pjesë e Administratës së Burimeve Njerëzore (HRA), një agjenci e Departamentit të Shërbimeve Sociale (DSS) të qytetit të Nju Jorkut. Prindërit e nisin procesin e mbështetjes financiare për fëmijën duke plotësuar një formular regjistrimi për shërbimet ose referohen nga ndihma ekonomike. OCSS-ja gjen vendndodhjen e prindit jokujdestar, i dorëzon fletëthirrjen dhe përcakton atësinë/mëmësinë. Pasi jepet urdhri i mbështetjes financiare për fëmijën në Gjykatën e Çështjeve Familjare, OCSS-ja monitoron, mbledh dhe shpërndan pagesat. Nëse ka vonesa me pagesat, OCSS-ja ka autoritetin të realizojë ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrit të mbështetjes financiare për fëmijën nëpërmjet mjeteve administrative.

GJYKATA E ÇËSHTJEVE FAMILJARE është pjesë e sistemit të unifikuar të gjykatave në shtetin e Nju Jorkut. Roli i gjykatës në procesin e mbështetjes financiare për fëmijën fillon kur një prind, kujdestar, ose Departamenti i Shërbimeve Sociale në qytetin e Nju Jorkut (DSS) bën një kërkesë për përcaktimin e atësisë/mëmësisë dhe/ose mbështetje financiare për fëmijën. Gjykata është përgjegjëse për lëshimin e urdhrave të rinj të mbështetjes financiare dhe mjekësore për fëmijën dhe për ndryshimin e atyre ekzistues. Nëse ka vonesa me pagesat, në gjykatë mund të paraqitet ankesë për moszbatim të urdhrit. Në këto raste, gjykata ka autoritetin të realizojë ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrit të mbështetjes financiare për fëmijën nëpërmjet mjeteve juridike.

MBËSHËTETJA FINANCIARE PËR FËMIJËN ËSHTË E RËNDËSISHME

Prindi jokujdestar është i detyruar të paguajë mbështetje derisa fëmija të emancipohet (zakonisht kur arrin moshën 21 vjeçare). Pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën mund t'ju ndihmojnë të plotësoni nevojat e përditshme të fëmijës tuaj dhe t'i siguronin atij një të ardhme më të sigurt nga pikëpamja financiare. Krahas ofrimit të mbështetjes financiare, pjesa më e madhe e prindërve jokujdestarë duan të angazhohen me fëmijët e tyre dhe ata që e paguajnë mbështetjen financiare për fëmijën kanë më shumë gjasa të interesohen për jetën për fëmijën së tyre dhe të kalojnë më shumë kohë me ta. Fëmijët e tyre kanë tendencën të kenë një status më të mirë social; ata ndjekin shkollën për një kohë më të gjatë, marrin nota më të mira në shkollë dhe kanë më pak probleme me sjelljen.

Ju duhet të merrni një urdhër të mbështetjes financiare për fëmijën edhe nëse prindi jokujdestar nuk e paguan dot momentalisht mbështetjen financiare për fëmijën. Dhe nëse nuk përcaktohet atësia/mëmësia, ky është një hap fillestar i rëndësishëm. Përcaktimi i atësisë/mëmësisë është në interesin më të lartë të fëmijës tuaj, pasi i jep fëmijës të drejtën për përfitime nga sigurimet shoqërore, përfitime në rast vdekjeje, përfitime ushtarake si dhe akses në informacionin mjekësor.

Urdhri i mbështetjes financiare për fëmijën do të bazohet te të ardhurat aktuale, por mund të ndryshojë në të ardhmen nëse ndryshojnë rrethanat. Nëse prindi jokujdestar nuk është në marrëdhënie pune, magjistrati mbështetës do të lëshojë një urdhër për pagesën në kushte varfërie (25\$ ose 0\$ në muaj dhe detyrime të prapambetura deri në 500\$). OCSS-ja ka programe punësimi për të ndihmuar ata që nuk e paguajnë dot mbështetjen financiare për fëmijën pasi janë të papunë ose bëjnë punë me të ardhura të ulëta. Magjistrati mbështetës mund të kërkojë që një prind jokujdestar të kërkojë punësim ose të marrë pjesë në një program punësimi në kohën e lëshimit të urdhrin. Pasi prindi jokujdestar të fillojë të paguhet rregullisht, OCSS-ja mund të mbledhë automatikisht pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën nga paga e tij dhe t'ia dërgojë ato prindit kujdestar. Nëse urdhri është 0\$, atëherë nuk mund të merret asnjë shumë derisa urdhri të modifikohet.

Në vitin 2021, OCSS-ja zbatoi dy programe marrëveshjeje. Ato i lejojnë prindërve të bisedojnë jashtë gjykatës rreth shumës së mbështetjes financiare për fëmijën, përpara seancës gjyqësore. Njëri program është për përcaktimin e shumës së urdhrin, ndërsa tjetri për modifikimin ose ndryshimin e një urdhri ekzistues. Prindërit që plotësojnë kualifikimet mund të arrijnë një marrëveshje duke biseduar me një punonjës social të mbështetjes financiare për fëmijën. Nuk është e nevojshme që të dy prindërit të jenë në telefon ose të pranishëm njëkohësisht.

- Përgatitet një marrëveshje me një përfaqësues të OCSS-së dhe duke përdorur të njëjtat rregulla si gjykata.
- Marrëveshja dorëzohet në gjykatë për miratim dhe konvertohet në urdhër pas miratimit.
- Gjykata kërkon që të dy prindërit të marrin pjesë në të paktën një seancë gjyqësore për t'u siguruar që kanë marrë pjesë vullnetarisht në proces dhe që i kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.
- Këto dy programe u ofrojnë prindërve një qasje alternative për përcaktimin dhe modifikimin e urdhrave të mbështetjes financiare për fëmijën, gjë që duhet të reduktojë numrin e seancave gjyqësore, duke fuqizuar kështu prindërit dhe duke e bërë procesin më miqësor për prindërit krahasuar me procesin e zakonshëm.



PROGRAMI I MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

REGJISTRIMI NË SHËRBIMET E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Prindërit kujdestarë, që po aplikojnë ose po marrin ndihmë ekonomike ose vetëm ndihmë mjekësore (MAO), referohen automatikisht në një zyrë të OCSS-së për shërbimet e mbështetjes financiare për fëmijën. Bashkëpunimi me mbështetjen financiare për fëmijën është i domosdoshëm për të marrë përfitimet e plota në para dhe/ose Medicaid për familjen e tyre.

Prindërit kujdestarë të cilët nuk po aplikojnë apo marrin ndihmë ekonomike ose MAO mund të aplikojnë për shërbimet e mbështetjes financiare për fëmijën nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:

- Përmes aplikacionit për telefona celularë nyc.gov/childsupportmobile (për të shkarkuar aplikacionin shkoni në App Store ose Google Play);
- Fizikisht në OCSS-në e Shërbimeve të Mbështetjes në Gjykatën e Çështjeve Familjare (FCSS) Zyra gjendet (<https://on.nyc.gov/contactocss>) në Gjykatën e Çështjeve Familjare në zonën ku jetojnë;
- Shkarkoni formularin e regjistrimit në www.nyc.gov/hra/ocss dhe më pas dërgoni me postë të OCSS-ja një formular regjistrimi të nënshkruar ose dërgojeni me email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us me subjekt "Formular Regjistrimi i Mbështetjes Financiare për Fëmijën."

Çdo i rritur që jeton dhe kujdeset për një të mitur mund të regjistrohet në shërbimet e mbështetjes financiare për fëmijën. Nuk është e nevojshme të kesh kujdestari ligjore.

OCSS-ja do të kërkojë dokumente që mund të ndihmojnë me gjetjen e vendndodhjes së prindit jokujdestar dhe vërtetojnë marrëdhënien tuaj dhe të fëmijës suaj me prindin jokujdestar. Jepni sa më shumë prej informacioneve të mëposhtme që të mundeni:

- Numrin e sigurimeve shoqërore të prindit jokujdestar ose Numrin Individual të Identifikimit të Tatimpaguesit (ITIN)
- Certifikatën e lindjes së secilit fëmijë që do të përmendet në kërkesë
- Certifikatën e martesës, vendimin e divorcit, ose letrat e ndarjes, sipas rastit
- Njohjen e atësisë/mëmësisë ose urdhrin e njohjes së atësisë nga Gjykata e Çështjeve Familjare, sipas rastit
- Adresën dhe numrin (-at) e telefonit të prindit jokujdestar
- Emrin dhe adresën e punëdhënësit të prindit jokujdestar
- Fotografi të kohëve të fundit

Nëse nuk jeni në dijeni të vendndodhjes apo nuk e dini numrin e sigurimeve shoqërore ose ITIN-in e prindit jokujdestar, jepni informacionin e mëposhtëm për të na ndihmuar ta identifikojmë atë:

- Datëlindjen dhe vendlindjen
- Adresën e tij të fundit që ju dini
- Emrin e prindërve të tij/saj (duke përfshirë mbiemrin e nënës para martesës)

GJETJA E VENDNDODHJES SË PRINDIT JOKUJDESTAR

Shumë prindër kujdestarë e dinë se ku banon ose punon prindi tjetër. Nëse ky informacion nuk është i disponueshëm, OCSS-ja do të kërkojë në bazën e të dhënave në kompjuter për të gjetur adresën dhe punëdhënësin aktual të prindit jokujdestar.

Prindi jokujdestar mund të jetë babai ose nëna. Në rastet kur personi që kujdeset për fëmijën nuk është prindi biologjik, nëna dhe babai konsiderohen prindër jokujdestarë të cilët janë të detyruar të paguajnë mbështetje financiare për fëmijën. OCSS-ja mund të gjejë vendndodhjen e prindërve të cilëve nuk iu dihet vendndodhja dhe që jetojnë në shtete të tjera. Na lajmëroni menjëherë nëse mësoni informacione të reja që mund të na ndihmojnë për të gjetur vendndodhjen e prindit jokujdestar.

PËRCAKTIMI I ATËSISË/MËMËSISË

Kur prindërit për fëmijën në momentin e lindjes nuk janë të martuar, atësia/mëmësia duhet të përcaktohet përpara se të lëshohet urdhri i mbështetjes financiare për fëmijën:

- Përcaktimi i atësisë/mëmësisë i jep fëmijës suaj përfitime që mund të përfshijnë sigurime shoqërore, pension ushtarak, pension, mbështetje financiare për fëmijën, sigurime shëndetësore dhe të drejtën për të trashëguar nga prindi tjetër.
- Atësia/mëmësia mund të përcaktohet në spital sapo fëmija të ketë lindur, ose në çdo kohë përpara moshës 21 vjeçare. Nëse të dy prindërit bien dakord, ata mund të nënshkruajnë një formular për njohjen e atësisë/mëmësisë (AOP), i cili bëhet dokument ligjor në momentin që dorëzohet në Departamentin e Shëndetit dhe Higjienës Mendore (DOHMH). Atësia/mëmësia mund të përcaktohen edhe në një seancë gjyqësore në Gjykatën e Çështjeve Familjare. Secili prind mund të bëjë kërkesë për seancë gjyqësore për përcaktimin e atësisë/mëmësisë.
- Nëse identiteti i prindit tjetër nuk dihet, laboratorët e certifikuar nga shteti i Nju Jorkut ofrojnë analizë ADN-je me kosto të ulët (<https://bit.ly/ocssdnatest>). Për më shumë informacione ose për referime, kontaktoni linjën OCSS ADN në numrin 929-221-5008. Nëse keni një datë të planifikuar për t'u paraqitur në Gjykatën e Çështjeve Familjare për një seancë gjyqësore për mbështetjen financiare për fëmijën, nuk mund ta kërkonit vetë analizën e ADN-së me kosto të ulët. Magjistrati mbështetës do të urdhërojë kryerjen e analizës së ADN-së nëse është e nevojshme të përcaktohet atësia/mëmësia.

DËRGIMI I FLETËTHIRRJES

Pasi të jetë dorëzuar kërkesa për përcaktimin e atësisë/mëmësisë dhe/ose mbështetjes financiare për fëmijën, prindi jokujdestar duhet të njoftohet me atë të një fletëthirrjeje për datën dhe orën e seancës gjyqësore të mbështetjes financiare për fëmijën. Nëse kërkohet, OCSS-ja do t'jua ofrojë shërbimin e dërgimit të fletëthirrjes, zakonisht me postë, pa asnjë kosto. Nëse preferoni, mund ta bëni vetë këtë duke dërguar dikë tjetër për të dorëzuar fletëthirrjen. Ju nuk mund ta dorëzoni fletëthirrjen personalisht.

DËRGIMI I ÇËSHTJES NË GJYKATË

Si mund të paraqitni një marrëveshje përpara gjykatës

Prindit kujdestar dhe atij jokujdestar do t'u jepet mundësia për të arritur një marrëveshje në mënyrë të vullnetshme përpara paraqitjes në gjykatë. Kjo lloj marrëveshjeje bazohet në udhëzimet standarde të mbështetjes financiare për fëmijën të përdorura nga Gjykata, por do të diskutohet nga prindi ose prindërit me një përfaqësues të shërbimit të klientit të Zyrës së Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (OCSS). Është një alternativë e procesit gjyqësor zyrtar dhe është krijuar për të qenë miqësore dhe mbështetëse, duke u mundësuar të dy prindërve mundësinë për të biseduar.

Për një marrëveshje:

- Një punonjës i OCSS-së e harton marrëveshjen sipas udhëzimeve dhe i ndihmon prindërit të mbledhin dokumentet e kërkuara.
- Paketa e miratuar e marrëveshjes dorëzohet në gjykatë për të caktuar një seancë gjyqësore.
- Zakonisht kërkohet vetëm një paraqitje në gjykatë që magjistrati mbështetës të sigurohet që prindërit e kanë arritur këtë marrëveshje vullnetarisht dhe për të miratuar marrëveshjen si një urdhër me pëlqim nga të dy palët.

Nëse jeni të interesuar të mësoni më shumë rreth lidhjes së një marrëveshjeje, telefononi në numrin 1-929-252-5289 ose dërgoni email në dcse.cseweb@dfa.state.ny.us me subjektin "CSSAP" për të lënë një takim dhe për të mësuar më shumë.

Sa para do të marr?

Shuma e të ardhurave të mbështetjes financiare për fëmijën bazohet në mbështetjen financiare për fëmijën të përcaktuar nga gjykata. Në rast se prindi jokujdestar paguan, shumën e plotë e të ardhurave nga mbështetja financiare për fëmijën u shpërndahet prindërve kujdestarë, përveç rastit kur marrin ndihmë ekonomike. Për klientët me ndihmë ekonomike, ata marrin deri në 100\$ të ardhura nga mbështetja financiare për një fëmijë dhe 200\$ për dy fëmijë, krahas shumës së ndihmës ekonomike. Në ato situata kur fëmija qëndron në kujdestari, e gjithë mbështetja financiare për fëmijën mbahet nga DSS-ja.

Sa kohë zgjat procesi para marrjes së pagesës?

I gjithë procesi nga regjistrimi në shërbime deri në marrjen e një urdhri gjykate mund të zgjasë për disa muaj, nëse dihet vendndodhja e prindit jokujdestar. Nëse prindi jokujdestar është i punësuar, punëdhënësi i dërgohet një Urdhër për Mbajtjen e të Ardhurave (IWO) dhe pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën zakonisht priten të vijnë brenda një muaji nga marrja e IWO-së nga punëdhënësi.

Çfarë duhet të dini për seancën gjyqësore

Në gjykatë, magjistrati mbështetës dëgjon dëshminë dhe rishikon informacionin e të ardhurave dhe shpenzimeve të të dy prindërve. Ky informacion do të përdoret për të llogaritur sa mbështetje duhet të japë prindi jokujdestar.

- Gjykata e Çështjeve Familjare është krijuar në mënyrë që ju të mund të vetëpërfaqësoheni. Ju nuk keni nevojë për avokat, por mund të punësoni një nëse dëshironi. Ka në dispozicion disa opsione **me kosto të ulët** (<https://on.nyc.gov/low-cost-legal>).
- Të dy prindërit duhet të paraqiten në seancën gjyqësore. Kur të dy prindërit vijnë të përgatitur me dokumentet e tyre financiare, mund të ketë më pak seanca gjyqësore. Nëse prindi jokujdestar nuk paraqitet në seancën gjyqësore ose nuk jep informacione të mjaftueshme për të ardhurat e tij/saj, magjistrati mbështetës mund ta shtyjë seancën gjyqësore dhe ta planifikojë në një datë tjetër. Në këtë rast, prindi kujdestar duhet të paraqitet në seancën gjyqësore të radhës ose çështja mund të pushohet. Magjistrati mbështetës mund të vazhdojë pa praninë e prindit jokujdestar dhe të lëshojë një urdhër standard nëse ka prova se është dërguar fletëthirrja.
- Nëse njëri prej prindërve nuk pajtohet me urdhrin e mbështetjes financiare për fëmijën, në zyrën e nëpunësit të gjykatës mund të paraqitet një kundërshtim me shkrim brenda 30 ditëve nga data e urdhrit ose brenda 35 ditëve nga data kur urdhri u është dërguar me postë palëve. Prindi tjetër do të ketë mundësinë t'i përgjigjet kundërshtimit. Një gjyqtar i Gjykatës së Çështjeve Familjare do ta rishikojë dosjen e çështjes dhe do të marrë një vendim.

Dokumentet e nevojshme

- Deklarata e plotësuar financiare (<https://bit.ly/FinDisclosure>)
- Dëshmi për të ardhurat dhe asetet si fletëpagesat, deklaratat tatimore, llogaritë bankare, investimet dhe pronat
- Dëshmi për shpenzimet shtëpiake si qiraja dhe ushqimi
- Dëshmi për kostot mjekësore, të kujdesit ndaj fëmijës dhe arsimit

Paraqitja juaj në gjykatë

- Mbërrini në kohë
- Vishuni në mënyrë të përshtatshme
- Ejani me një listë të përgatitur rreth pikave të rëndësishme dhe përmbajuni atyre duke qenë se koha është e kufizuar
- Ejani me deklaratë financiare të plotësuar dhe me dokumente të tjera mbështetëse
- Flisni kur të keni radhën; mos iu drejtoni në mënyrë të drejtpërdrejtë prindit tjetër.

URDHRAT E MBËSHTETJES FINANCIARE DHE MJEKËSORE PËR FËMIJËN

Me qëllim që urdhrat e mbështetjes financiare për fëmijën në shtetin e Nju Jorkut të jenë të drejta dhe të qëndrueshme, Ligji për Standardet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën përcakton shumën bazë të mbështetjes financiare për fëmijën në një përqindje fikse të të ardhurave të prindërve. Magjistrati mbështetës duhet të përdorë përqindjet për të vendosur shumën e mbështetjes financiare për fëmijën që prindi jokujdestar duhet të paguajë, përveç rasteve kur ka arsye të dokumentuara për të mos e bërë këtë. Përdorimi i këtyre përqindjeve siguron që fëmijët të përfitojnë nga i njëjti standard jetese ashtu si do të përfitonin nëse prindërit e tyre do të jetonin së bashku. Ligji i lejon magjistratit mbështetës të jetë fleksibel dhe të mund të devijojë deri diku në përputhje me arsyet e përcaktuara në ligj.

Si llogaritet shuma e urdhrat

Sipas ligjit, shuma bazë e mbështetjes që prindi jokujdestar duhet të paguajë është një përqindje e të ardhurave bruto të tij/saj minus taksat e NYC-së, zbritjet nga pagimi i Sigurimeve Shoqërore dhe Medicare dhe ndonjë mbështetje financiare për fëmijën ose bashkëshortin që i jepet një familjeje tjetër dhe varet nga numri i fëmijëve që janë të përfshirë.

Të ardhurat përfshijnë pagën nga një punë, shpërblimin e punonjësit, pagesat e invaliditetit, përfitimet e papunësisë, pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shumë burime të tjera të ardhurash. Nuk përfshin ndihmën ekonomike ose të ardhurat e sigurimit suplementar (SSI).

Kjo përqindje përdoret për të gjitha rastet kur të ardhurat totale të të dy prindërve nuk janë më shumë 163,000\$. Në rastet kur të ardhurat totale janë mbi 163,000\$, magjistrati mbështetës mund të vendosë nëse do të përdoren udhëzimet për përqindjet dhe mund të marrë parasysh informacione për të përcaktuar shumën e plotë të mbështetjes financiare.

Ligji parashikon mbrojtje për prindërit jokujdestarë me të ardhura të ulëta. Ata që fitojnë më pak se rezerva e vetëmbështetjes së shtetit të Nju Jorkut mund të marrin një urdhër mujor prej 50\$, dhe ata që fitojnë në ose nën nivelin federal të varfërisë mund të marrin një urdhër për pagesë në kushte varfërie prej 25\$ në muaj dhe të kenë detyrime të prapambetura në shumën 500\$. Përcaktimi i një urdhri është i vlefshëm. OCSS-ja do të punojë me prindërit jokujdestarë me të ardhura të ulëta për t'i lidhur me shërbimet e punësimi. Kur të ardhurat e tyre të rriten, është e mundur që urdhri të rritet.

Nr. i fëmijëve	%
1	17%
2	25%
3	29%
4	31%
5+	të paktën 35%

OCSS-ja ofron një metodë llogaritjeje online (<http://bit.ly/CSCalc>) që mund t'ju japë një ide rreth shumës së mbështetjes financiare që mund të përcaktohet për fëmijën.

Çfarë përfshin urdhri i mbështetjes financiare për fëmijën

- Shumën e detyruar sipas Ligjit të Shtetit të Nju Jorkut për Standardet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën.
- Mbështetje mjekësore, që përfshin kostot e kujdesit shëndetësor për fëmijën si pagesat për sigurimin shëndetësor, zbritjet dhe bashkëpagesat. Kostot e mbështetjes mjekësore ndahen mes të dy prindërve, në bazë të të ardhurave që kanë. Secilit prind mund t'i kërkohet që ta regjistrojë fëmijën në një plan sigurimi shëndetësor nëse ofrohet përmes punës së tij ose saj. Sigurimi duhet të ketë një kosto të arsyeshme për punëmarrësin dhe shërbimet mjekësore duhet të jenë të disponueshme aty ku fëmija jeton.
- Në urdhrin e mbështetjes financiare për fëmijën mund të përfshihen edhe shpenzimet për një arsimim të arsyeshëm dhe për kujdesin ndaj tij. Këto shpenzime zakonisht ndahen mes dy prindërve, në bazë të të ardhurave që kanë. Si shpenzimet mjekësore ashtu dhe ato për arsimin, nëse përfshihen, shtohen mbi shumën bazë të urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën.

MBLEDHJA E PAGESAVE TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Urdhri juaj i mbështetjes financiare për fëmijën do të bëhet i pagueshëm për Njësinë për Marrjen e Mbështetjes (SCU) së OCSS-së. Ne do të marrim rregullisht pagesat nga prindi jokujdestar, zakonisht përmes zbritjes nga paga. Pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën do t'ju dërgohen në mënyrë elektronike, nëpërmjet depozitimit direkt në bankë, ose përmes programit Debit MasterCard të shtetit të Nju Jorkut. Vetëm në raste të vështira do të dërgohen çeqe. Për depozitim të drejtpërdrejtë në llogarinë tuaj të kursimeve ose rrjedhëse, mund ta plotësoni, nënshkruani dhe dërgoni formularin në childsupport.ny.gov. Mund të shikoni videon se si të plotësoni formularin e regjistrimit për depozitim të drejtpërdrejtë në listën e luajtjes së HRA OCSS në YouTube në youtube.com/hranyc. Nëse nuk regjistroheni për depozitim të drejtpërdrejtë, do të merrni pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën tuaj nëpërmjet programit të kartës së debitit të shtetit të Nju Jorkut.

Nëse ndryshoni adresën, është e rëndësishme që t'i jepni OCSS-së adresën e re <https://on.nyc.gov/3FAiB0S> në mënyrë që ne të mund t'ju kontaktojmë dhe për t'u siguruar që të merrni të gjitha pagesat dhe komunikimet e tjera të rëndësishme.

Mund t'ju tarifohen 35\$ si tarifë shërbimi. Tarifa aplikohet vetëm për prindërit jokujdestarë që nuk kanë marrë asnjëherë përfitime në ndihmë ekonomike në asnjë shtet. Tarifa do të tarifohet nëse keni paguar të paktën 550\$ mbështetje gjatë vitit fiskal federal (1 tetor-30 shtator). Tarifa do të vazhdojë të aplikohet për çdo vit fiskal federal kur janë paguar 550\$ ose më shumë.

OCSS-ja nuk mund të ofrojë shërbime për mbledhjen ose ekzekutimin e detyrueshëm nëse keni një urdhër që ju paguhet drejtpërdrejt. Ju mund të kërkonin ndryshimin e përfituesit nga pagesa direkte në të pagueshme përmes Njësisë së Marrjes së Mbështetjes (SCU) <https://on.nyc.gov/3TNqXXv> në Zyrën e Shërbimeve të Mbështetjes në Gjykatën e Çështjeve Familjare (FCSS) të OCSS-së në Gjykatën e Çështjeve Familjare në zonën tuaj. Ndryshimi i përfituesit mund të bëhet për çdo urdhër mbështetjeje financiare për fëmijën të lëshuar nga Gjykata e Çështjeve Familjare ose Gjykata Supreme pa seancë gjyqësore.

EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM I URDHRIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Ekzekutimi i detyrueshëm është ndërmarrja e veprimeve të duhura për të marrë mbështetjen e prapambetur financiare për fëmijën dhe për të siguruar bërjen e pagesave aktuale dhe atyre të ardhshme. Procesi i ekzekutimit të detyrueshëm fillon kur urdhri bëhet i pagueshëm për Njësinë e Marrjes së Mbështetjes (SCU) dhe kur urdhri përfundon dhe çdo pagesë e prapambetur është paguar. Kur ka pagesa të prapambetura, mund të përdoren mjetet e ekzekutimit të detyrueshëm për të marrë pagesat e detyruara.

Disa veprime ekzekutuese janë administrative. Kjo do të thotë se nuk është e nevojshme të zhvillohet seancë gjyqësore. OCSS-ja ka autoritetin të realizojë ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrave duke përdorur këto metoda:

- Rritjen e shumës së pagesave me 50% për të reduktuar borxhin e pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën (pagesat e prapambetura)
- Marrjen e parave nga llogaritë bankare, rimbursimet e taksave për të ardhurat, fitimet nga lotaritë, dhe marrëveshjet e sigurimeve
- Pezullimin e lejes së drejtimit
- Raportimin e pagesave të prapambetura të mbështetjes financiare për fëmijën te agjencitë e raportimit të kreditit.
- Referimin e rasteve te Departamenti i Tatimeve dhe Financës të shtetit të Nju Jorkut për shlyerjen e borxhit të mbështetjes financiare për fëmijën
- Refuzimin e marrjes ose rinovimin e pasaportës
- Refuzimin e marrjes ose rinovimin e licencave profesionale, lejeve, regjistrimin dhe certifikatat për biznese në qytetin e Nju Jorkut.

Agjencitë e licencimit të NYC përfshijnë, Komisionin e Taksive dhe Limuzinave, Departamentin e Çështjeve të Konsumatorit, Departamentin e Zjarrfikëses dhe Departamentin e Policisë, por jo vetëm.

Veprimet e tjera ekzekutuese janë gjyqësore. Kjo do të thotë se është e nevojshme të zhvillohet seancë gjyqësore. Nëse ju nuk merrni ndihmë ekonomike, duhet të dorëzoni një ankesë për moszbatim. Metodat e ekzekutimit të detyrueshëm gjyqësor përfshijnë:

Seancë gjyqësore për shkeljen. Kjo mund të rezultojë në të mëposhtmet:

- Përcaktimin e shumës së parave nga gjykata me interes të shtuar (i detyrueshëm me ligj për të gjitha seancat e shkeljeve)
- Ngrirjen e ndonjë prone

- Angazhimin në para (depozitë me vlerën e mbështetjes financiare për fëmijën të deri tre viteve) për të garantuar pagesën e mbështetjes financiare për fëmijën në të ardhmen
- Pjesëmarrjen në një program punësimi
- Pezullimin e licencave profesionale, për biznese, dhe atyre të argëtimit të lëshuara nga shteti. Agjencitë shtetërore të licencimit përfshijnë, Departamentin e Arsimit, të Shtetit dhe të Ruajtjes së Mjedisit, Zyrën e Administrimit të Gjykatës dhe Autoritetin e Pijeve Alkoolike, por jo vetëm
- Burgosje
- Referim për ndjekje penale

NDRYSHIMI I VLERËS SË URDRIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Ndryshimi i shumës përmes Gjykatës së Çështjeve Familjare

Secili prind mund të bëjë një kërkesë në Gjykatën e Çështjeve Familjare për të modifikuar (ndryshuar) shumën e urdhrin të mbështetjes financiare për fëmijën nëse rrethanat ndryshojnë, çka mund të përkufizohet si ndryshim i konsiderueshëm dhe i paplanifikuar i tyre, ose nevojat për fëmijën nuk po plotësohen. Magjistrati mbështetës do të shqyrtojë informacionin e ri të paraqitur dhe do të vendosë nëse duhet të bëhet një ndryshim.

Standardet e mëposhtme shtesë për modifikim zbatohen për urdhrat e mbështetjes financiare për fëmijën të krijuar më 13 tetor 2010 ose më vonë.

- Kanë kaluar tre vite që kur urdhri ka hyrë në fuqi, është modifikuar ose ndryshuar për herë të fundit.
- Ka pasur një ndryshim në të ardhurat bruto me 15% ose më shumë që nga koha që urdhri ka hyrë në fuqi, modifikuar ose ndryshuar për herë të fundit. Çdo ulje e të ardhurave duhet të jetë e pavullnetshme dhe prindi që pretendon ulje të të ardhurave duhet të ketë bërë përpjekje të konsiderueshme për të gjetur punë në bazë të arsimit, aftësisë dhe përvojës së tij/saj.
- Individët e burgosur mund të paraqesin një kërkesë modifikimi për shkak të një ndryshimi thelbësor të rrethanave, për sa kohë që burgosja e tyre nuk është për shkak të mospagesës së mbështetjes financiare për fëmijën ose shkeljeje ndaj prindit kujdestar ose fëmijës.
- Çdo ndryshim i urdhrin do t'i referohet datës së depozitimit të kërkesës në gjykatë, jo datës kur ka ndodhur ndryshimi i rrethanave.

Modifikimi i urdhrave përmes marrëveshjes (MOTS)

Për të ndryshuar urdhrin e mbështetjes financiare për fëmijën, krahas procesit të gjatë gjyqësor, mund të bëhet një marrëveshje mes prindit kujdestar dhe atij jokujdestar, i cili mund të lehtësohet nga OCSS-ja. Ky program, i quajtur Modifikimi i Urdhrave Përmes Marrëveshjes (MOTS), zakonisht kërkon paraqitje në një seancë të shkurtër gjyqësore që rezulton në lëshimin e një urdhri mbështetjeje financiare për fëmijën, për të cilin kanë rënë dakord të dyja palët.

MOTS-i u jep prindërve kujdestarë dhe jokujdestarë mundësinë për të diskutuar, për të bërë pyetje dhe për të arritur një marrëveshje për shumën e re të detyrimit të mbështetjes financiare për fëmijën. Kjo realizohet me një punonjës social për fëmijët, jashtë Gjykatës së Çështjeve Familjare, duke përdorur të njëjtat udhëzime si gjykata. Sapo të arrihet një marrëveshje dhe të dy prindërit ta nënshkruajnë, planifikohet një seancë gjyqësore. Prindërit duhet të paraqiten, por zakonisht vetëm një herë.

Ndryshimi i shumës së urdhrin përmes ndryshimit të kostos së jetesës (COLA)

Urdhrat e mbështetjes financiare për fëmijën mund të rriten me një ndryshim të kostos së jetesës (COLA) pa iu drejtuar sërish gjykatës. Vetëm prindërit kujdestarë, urdhrat e mbështetjes financiare për fëmijën e të cilëve paguhen përmes OCSS-së, mund të përfitojnë nga COLA. Shuma e COLA-s bazohet në ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit për zonat urbane (CPI-U), i cili gjurmon çmimet e artikujve për ushqim, veshmbathje, banesa, transport, karburante dhe shpenzime mjekësore.

COLA mund t'i shtohet një urdhri mbështetjeje financiare për fëmijën kur rritjet vjetore të CPI-U-së shtohen deri në të paktën 10% nga data e krijimit ose modifikimit të fundit të urdhrin. Mund të duhen disa vite për të arritur rritjen e kërkuar prej 10% të CPI-U-së. Personat që marrin ndihmë ekonomike e marrin automatikisht COLA-n kur rastet e tyre të mbështetjes financiare për fëmijën bëhen të pranueshme. Personat që nuk marrin ndihmë ekonomike njoftohen me postë kur rastet e tyre plotësojnë kërkesat për një COLA. Ata duhet t'i përgjigjen njoftimit në mënyrë që të marrin rritjen.

Ndryshimi i urdhrin kur fëmija emancipohet

Urdhrat mund të ndahen. Kjo do të thotë se përcaktohet një shumë e caktuar në dollarë për secilin fëmijë. Kur ndodh kjo, tekta fëmija emancipohet, urdhri do të ndryshohet automatikisht pas emancipimit të secilit fëmijë. Disa urdhra nuk ndahen. Në këto raste, të dy prindërit/kujdestarët duhet të kthehen në gjykatë për të modifikuar urdhrin në mënyrë që të pasqyrohet emancipimi i fëmijës.

SHFUQIZIMI I URDRIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Në shtetin e Nju-Jorkut, prindi jokujdestar është i detyruar të paguajë mbështetje derisa fëmija të emancipohet (zakonisht kur arrin moshën 21 vjeçare). Kur fëmija më i vogël në moshë i përfshirë në një çështje arrin moshën 21 vjeçare, nuk është e nevojshme të bëhet asnjë veprim për të përfunduar urdhrin pasi kjo ndodh automatikisht. Në rethana të veçanta, urdhrat për mbështetjen financiare të fëmijës mund të shfuqizohen nga gjykata para moshës 21 vjeçare kur:

- Fëmija emancipohet - largohet nga shtëpia dhe është i aftë të mbajë veten, martohet, ose i bashkohet ushtrisë.
- Prindi jokujdestar merr kujdestarinë për fëmijën. Në atë rast prindi jokujdestar duhet të bëjë një kërkesë për të shfuqizuar urdhrin dhe për të krijuar një urdhër të ri për prindin kujdestar të mëparshëm.
- Ju riktheheni me prindin tjetër dhe krijoni një familje. Sërish, duhet të bëhet një kërkesë në gjykatë për të shfuqizuar urdhrin.

Pasi të përfundojë urdhri, ju mund të keni ende të drejtën për të marrë mbështetje financiare për fëmijën nëse pagesat e prindit jokujdestar nuk ishin të përditësuara dhe ai ose ajo ka paqesa të prapambetura.



DIVORCI DHE MBËSHTETJA FINANCIARE PËR FËMIJËN

Në shtetin e Nju Jorkut, rastet e divorcit dërgohen në Gjykatën Supreme. Lëshohet një vendim, ku përcaktohen kushtet e divorcit. Vendimi i divorcit mund të përfshijë një urdhër të mbështetjes financiare për fëmijën. Shuma e urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën mund të vendoset nga të dy prindërit dhe avokatët e tyre ose gjyqtari i Gjykatës Supreme që shqyrton çështjen. Nëse gjyqtari përcakton shumën e detyrimit, ai ose ajo do ta bazojë urdhrin në të njëjtin ligj të Standardeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën të shtetit të Nju Jorkut të përdorur në Gjykatën e Çështjeve Familjare. Ju mund të kërkonit që urdhri i mbështetjes financiare për fëmijën t'i paguhet OCSS-së dhe të përdorni shërbimet tona për mbledhjen dhe ekzekutimin e detyrueshëm të pagesave.

PËR TA BËRË KËTË:

1. Plotësoni formularin e regjistrimit të mbështetjes financiare për fëmijën (LDSS-5258) që gjendet në nyc.gov/hra/ocss, ose në <https://otda.ny.gov/programs/applications/5258.pdf>
2. Dërgoni me POSTË LDSS-5258, një kopje të plotë të vendimit të divorcit dhe tregoni që dëshironi ta konvertoni që t'i paguhet OCSS-së. Dërgojani pakon me postë:
*OCSS-së, drejtuar Drejtorit të Mirëmbajtjes së Llogarive
Kutia postare 830
Canal Street Station
New York, NY 10013 OSE*
3. Silleni vendimin e divorcit tuaj te zyra e OCSS-së për Shërbimet e Mbështetjes së Gjykatës së Çështjeve Familjare (FCSS) në Gjykatën e Çështjeve Familjare në zonën tuaj dhe regjistrohuni personalisht në shërbimet e mbështetjes financiare për fëmijën. Kështu vendimi i divorcit do të konvertohet në një urdhër të pagueshëm nga OCSS-ja.

Shuma e urdhrat të mbështetjes që do të vendoset në sistemin e kompjuterit do të jetë e njëjtë me atë në vendimin e divorcit të lëshuar nga Gjykata Supreme. Secili prind mund të paraqesë një kërkesë për të modifikuar urdhrin për mbështetjen e fëmijëve nëse ndryshojnë rrethanat e tyre ose nevojat për fëmijën. Nëse vendimi juaj i divorcit thotë se juridiksioni i mbetet Gjykatës Supreme, atëherë ju duhet të ktheheni në Gjykatën Supreme për të kërkuar modifikimin. Nëse urdhri thotë se Gjykata Supreme i jep juridiksion Gjykatës së Çështjeve Familjare, ose nuk e përmend fare juridiksionin, ju mund të ktheheni në secilën gjykatë.

Ju mund të shkoni direkt në Gjykatën e Çështjeve Familjare për t'u regjistruar për shërbimet e mbështetjes financiare për fëmijën nëse keni një vendim divorci që nuk përfshin një urdhër mbështetjeje financiare për fëmijën ose nuk keni filluar ende procesin e divorcit në Gjykatën Supreme. Pasi të keni dorëzuar dokumentet në Gjykatën Supreme dhe t'ju jetë caktuar një datë për një seancë, nuk mund të kërkonit një seancë gjyqësore për mbështetjen financiare për fëmijën në Gjykatën e Çështjeve Familjare derisa të zgjidhet çështja tjetër gjyqësore.



KUJDESTARIA DHE VIZITAT

Kujdestaria dhe vizitat nuk diskutohen dhe nuk përfshihen në seancën gjyqësore të mbështetjes financiare për fëmijën. OCSS-ja beson se prindërit jokujdestarë kanë më shumë gjasa të paguajnë mbështetje financiare për fëmijën nëse të dy prindërit/kujdestarët kanë një marrëveshje verbale ose me shkrim për takimet me fëmijët e tyre dhe/ose ndarjen e përgjegjësi. Një prind që ka nevojë për ndihmë me kujdestarinë dhe vizitat mund të paraqesë kërkesë në gjykatë për seancë gjyqësore për kujdestarinë dhe vizitat (<http://ww2.nycourts.gov/COURTS/nyc/family/faqscustodyandvisitation.shtml>). Në seancë, një gjyqtar ose arbitër mund t'i referojë prindërit në një shërbim ndërmjetësimi. Nëse arrihet një marrëveshje e kënaqshme përmes këtij procesi ndërmjetësimi të referuar nga gjykata, gjyqtari ose arbitri e kthen marrëveshjen në një urdhër gjykate. Nëse nuk arrihet marrëveshje, çështja kthehet në gjykatë dhe gjyqtari ose arbitri vendos për mënyrën e zgjidhjes së problemeve.

PËRDORIMI I NDËRMJETËSIMIT PËR TË ZGJIDHUR MOSMARRËVESHJET

Edhe shërbimet e ndërmjetësimi janë të disponueshme pa një referim nga gjykata për të diskutuar çështjet e rritjes së fëmijës. Prindërit mund të kontaktojnë drejtpërdrejt secilën prej organizatave të mëposhtme për shërbime ndërmjetësimi falas ose me kosto të ulët (<https://bit.ly/ocssmediation>):

- Qendra për Ndërmjetësim dhe Trajnim: 212-799-4302 (të gjithë klientët, tarifë sipas orës)
- Shërbimet e Ndërmjetësimi në Komunitet: 718-523-6868 (banorët e Queens-it)
- Instituti për Ndërmjetësimin dhe Zgjidhjen e Konfliktëve: 718-585-1190 (banorët e Bronx-it)
- Grupi i Ndihmës Ligjore të Nju Jorkut: hrasupport@nylag.org (klientët me të ardhura të ulëta)
- Instituti i Paqes në Nju Jork: 212-577-1740, 718-834-6671 (banorët e Brooklyn-it dhe Manhattan-it)
- Ndihma për prindin: 800-716-3468 (program federal që ofron një linjë telefonike falas dhe konfidenciale për nënat dhe baballarët që jetojnë të ndarë)

DHUNA NË FAMILJE DHE MBËSHTETJA FINANCIARE PËR FËMIJËN

Kur pjesa më e madhe e personave dëgjojnë fjalët “dhunë në familje”, mendojnë për dhunën fizike. Megjithatë, në disa raste, abuzuesit nuk i sulmojnë kurrë fizikisht viktimat e tyre. Forma të tjera abuzimi ose mënyra për të kontrolluar viktimat përfshijnë abuzimin emocional, seksual dhe financiar. Shumë abuzues përdorin paratë si mjet kontrolli. Një abuzues mund t’i mohojë viktimës aksesin në para, strehim ose automjet, duke e bërë të vështirë largimin ose qëndrimin larg. Abuzuesit mund të përdorin kërcënime që lidhen me mbështetjen financiare për fëmijën për të kontrolluar viktimat e tyre. Përveç kërcënimit të dhunës fizike, një abuzues mund të thotë se nuk do të merrni kurrë asnjë qindarkë mbështetjeje për fëmijën nëse largoheni ose se do të humbni kujdestarinë nëse kërkon mbështetje financiare për fëmijën.

Nëse keni ndonjë shqetësim, ju lutemi të lexoni informacionin për të gjithë aplikantët për mbështetje financiare për fëmijën në lidhje me marrjen e mbështetjes financiare për fëmijën në mënyrë të sigurt (W-280a) <https://on.nyc.gov/child-support-safely> i disponueshëm në faqen tonë të internetit www.nyc.gov/hra/ocss. Ky dokument përshkruan shërbimet që ne ofrojmë që mund të bëhen nxitëse të dhunës në familje. Nëse ende dëshironi të kërkon mbështetjen financiare për fëmijën, ka rrugë për ta bërë këtë në mënyrë të sigurt.

Nëse po aplikoni ose po merrni ndihmë ekonomike, është e nevojshme që të bashkëpunoni me mbështetjen financiare për fëmijën për të marrë përfitimet e plota për familjen tuaj. Por nëse ekziston rreziku i dhunës në familje, duhet t’i tregoni Specialistit për Mundësitë e Punësimit (JOS) në Qendrën e Punës ose punonjësit të rastit të mbështetjes financiare për fëmijën për frikën që keni dhe kjo kërkesë mund të mos aplikohet për ju.

Nëse nuk po aplikoni apo merrni ndihmë ekonomike dhe ekziston rreziku për dhunë në familje, mund të vendosni nëse dëshironi të përfitoni nga shërbimet e mbështetjes financiare për fëmijën. Shumë të mbijetuar të dhunës në familje kanë frikë të marrin mbështetjen financiare për fëmijën por duan që të vazhdojnë të ndjekin çështjen e mbështetjes pasi kanë nevojë për paratë. Pavarësisht situatës, shumë persona mendojnë që të dy prindërit duhet të jenë përgjegjës për fëmijët që kanë së bashku. Nëse vendosni të vazhdoni, në çdo moment mund të ndryshoni mendje.

- Kur i drejtoheni gjykatës për të bërë një kërkesë për mbështetje financiare për fëmijën, tregojini punonjësit të mbështetjes financiare për fëmijën që stafi i Gjykatës së Çështjeve Familjare është në dijeni të frikës që keni. Ata do të punojnë me ju për të siguruar privatësinë e informacionit të rastit dhe siguri në gjykatë. Mund të kërkon që gjykata:
 - » Të heqë informacionin e adresës dhe punësimin nga kërkesat, njoftimet dhe nga çdo lloj tjetër formulari i gjykatës
 - » Të mos i tregojë prindit tjetër vendbanimin dhe vendin tuaj të punës
 - » T’ju lejojë që të largoheni nga gjykata veçmas prindit tjetër
 - » Të urdhërojë që analizat e nevojshme të ADN-së për të përcaktuar atësinë/mëmësinë të kryhen në data të ndryshme
 - » T’ju referojnë te shërbimet e dhunës në familje
- Pasi të keni marrë një urdhër mbështetjeje financiare për fëmijën, OCSS-ja mund të realizojë ekzekutimin e detyrueshëm administrativ pa përfshirjen tuaj. Nëse situata juaj bëhet e rrezikshme dhe jeni të shqetësuar për sigurinë tuaj ose atë të fëmijëve tuaj, mund të kërkon që OCSS-ja ta mbyllë çështjen tuaj në çdo kohë.

Nëse jeni viktimë e dhunës në familje ose njihni dikë që është, ka opsione të disponueshme për ndihmë. Linja telefonike e qytetit të Nju Jorkut për dhunën në familje (800-621-HOPE) ofron informacione për këshillim, streha, shërbime për fëmijë dhe asistencë juridike.



INFORMACION PËR NDIHMËN EKONOMIKE DHE KLIENTËT E NDIHMËS MJEKËSORE

Do t'ju lihet një orar për një intervistë me zyrën e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (OCSS) në zonën tuaj nëse po aplikoni ose po merrni ndihmë ekonomike ose vetëm ndihmë mjekësore (MAO), ose keni nevojë të shtoni një fëmijë në rastin tuaj të ndihmës ekonomike. Gjatë intervistës, një punonjës i mbështetjes financiare për fëmijën do t'ju bëjë pyetje rreth prindit jokujdestar (prindin që nuk jeton me ju). Përfitimet tuaja mund të reduktohen nëse nuk merrni pjesë në takim ose nuk ofroni dokumentacion dhe informacion për prindin jokujdestar.

DOKUMENTET E NEVOJSHME

Dokumentet dhe informacioni që ju nevojitet për intervistën në zyrën e OCSS-së në zonën tuaj përfshijnë:

- Referimin e plotësuar që ju është dhënë së bashku me njoftimin e takimit (kopjet mund të gjenden në www.nyc.gov/hra/ocss)
- Numrin e sigurimeve shoqërore të prindit jokujdestar ose Numrin Individual të Identifikimit të Tatimpaguesit (ITIN)
- Certifikatën e lindjes së secilit fëmijë që do të përmendet në kërkesë
- Certifikatën e martesës, vendimin e divorcit, ose letrat e ndarjes, sipas rastit
- Njohjen e atësisë/mëmësisë ose urdhrin e njohjes së atësisë nga Gjykata e Çështjeve Familjare, sipas rastit
- Adresën dhe numrin (-at) e telefonit të prindit jokujdestar
- Emrin dhe adresën e punëdhënësit të prindit jokujdestar
- Fotografi të kohëve të fundit

Nëse nuk jeni në dijeni të vendndodhjes apo nuk dini numrin e sigurimeve shoqërore ose ITIN-in e prindit jokujdestar, informacioni i mëposhtëm do të na ndihmojë për ta identifikuar atë:

- Datëlindjen dhe vendlindjen
- Adresën e tij të fundit që ju dini
- Emrin e prindërve të tij/saj (duke përfshirë mbiemrin e nënës para martesës)

BASHKËPUNIMI ME SHËRBIMET E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Nëse po aplikoni për ose po merrni ndihmë ekonomike, është e nevojshme që të bashkëpunoni me OCSS-në në mënyrë që të merrni përfitimet e plota për familjen tuaj. Nëse nuk jepni informacionin e kërkuar, mund të sanksionoheni, që do të thotë se përfitimi juaj nga ndihma ekonomike mund të reduktohet me 25%, ju mund të humbisni përfitimin nga Medicaid, mund të humbisni të drejtën e kualifikimit për disa programe të ndihmës për qiramarrje ose mund t'ju reduktohet mbështetja financiare për shpenzimet e qirasë, dhe sanksioni do të mbetet në fuqi përveç rastit kur dhe derisa të jepni informacionin specifik të kërkuar dhe të respektoni detyrimet e lidhura me mbështetjen financiare për fëmijën.

Në disa situata, ka arsye të forta për të mos bashkëpunuar. Mund t'ju lejohet një pretendim për arsye të pranueshme për përjashtim për arsyet e mëposhtme:

- Nëse keni frikë se ju ose fëmija (-ët) juaj do të abuzoheni emocionalisht ose fizikisht nga prindi tjetër
- Fëmija erdhi nga një shtatzëni si pasojë e një incesti ose përdhunimi
- Po punoni me një agjenci birësimi që fëmija juaj të birësohet

Tregojni punonjësit të mbështetjes financiare për fëmijën nëse gjendeni në një nga këto situata. Do të referoheni te një këshillues për dhunën në familje nëse pretendimi juaj është rezultat i dhunës fizike ose emocionale. Konsulenti do të vlerësojë nëse keni arsye të pranueshme për përjashtim, dhe nëse kualifikoheni për përjashtim të pjesshëm ose të plotë, çka do të thotë se mund të duhet të plotësoni disa ose të gjitha nga kërkesat e mbështetjes financiare për fëmijën në këtë moment.

Nëse jeni sanksionuar për mospajtim, sanksionimi juaj mund të hiqet në çdo kohë nëse ofroni informacionin specifik të kërkuar dhe bini dakord me mbështetjen financiare për fëmijën. Gjithashtu mund të kontaktoni Zyrën e OCSS-së në zonë (<https://on.nyc.gov/contactocss>) dhe të bashkëpunoni.

DËRGIMI I ÇËSHTJES NË GJYKATË

Pritet që ju të merrni pjesë në seancën e mbështetjes financiare për fëmijën nëse/kur çështja juaj të kalojë në gjykatë. Në seancë do të jetë i pranishëm një avokat për të përfaqësuar Departamentin e Shërbimeve Sociale/Administratën e Burimeve Njerëzore (HRA) për qytetin e Nju Jorkut, agjencia që paraqet kërkesën për fëmijët që marrin ndihmë ekonomike. Por duhet të jeni të përgatitur për t'ju përgjigjur disa pyetjeve. Pavarësisht nëse çështja juaj e ndihmës ekonomike ose e vetëm ndihmës mjekësore mbyllet përpara datës së seancës, ju duhet të paraqiteni në seancë. Magjistrati mbështetës mund të përcaktojë atësinë/mëmësinë dhe/ose një urdhër mbështetjeje financiare për fëmijën nëse të dy prindërit janë të pranishëm.

Ju mund të kualifikoheni për të marrë pjesë në Programin e Marrëveshjes për Mbështetjen Financiare për Fëmijën (CSSAP). CSSAP-ja mund të thjeshtojë procesin e marrjes së mbështetjes financiare për fëmijën dhe mund të reduktojë kohën e shpenzuar në Gjykatën e Çështjeve Familjare. Telefononi numrin 1-929-252-5289 ose dërgoni email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us me subjekt "CSSAP" për të planifikuar një takim dhe për të mësuar më shumë.

KUJDESTARIA

Nëse fëmija juaj është në kujdestari, ju ia jepni të drejtat tuaja për të ardhurat nga mbështetja financiare për fëmijën Departamentit të Shërbimeve Sociale/Administratës për Shërbimet e Fëmijëve. Pasi të bashkoheni me fëmijën tuaj, të ardhurat nga mbështetja financiare për fëmijën do t'i merrni ju, përveç rastit kur merrni ndihmë ekonomike. Në këtë rast, aplikohet rregulli i ndihmës ekonomike, çka do të thotë se do të merrni pagesën e parë në shumën 100\$ (ose 200\$ për dy ose më shumë fëmijë) dhe pjesa tjetër mbahet nga DSS-ja.

SA MBËSHTETJE FINANCIARE PËR FËMIJËN MUND TË MERRNI NDËRSA MERRNI NDIHMË EKONOMIKE

- Pagesa e parë në shumën 100\$ (ose 200\$ për dy ose më shumë fëmijë) e marrë çdo muaj nga mbështetja financiare për fëmijën do t'ju dërgohet bashkë me ndihmën tuaj ekonomike. Ky është bonusi juaj ose pagesa tranzitore dhe është e disponueshme në kartën tuaj EBT. Në shumicën e rasteve, pjesa tjetër e parave të mbledhura përdoret për të paguar HRA-në për përfitimet e ndihmës ekonomike. Nëse keni pasur tashmë një urdhër të mbështetjes financiare për fëmijën përpara se të aplikoni për ndihmë ekonomike, ju mund të kualifikoheni për "pagesat e prapambetura familjare." Pyesni punonjësin social të mbështetjes financiare për fëmijën nëse kualifikoheni.

- Çdo pagesë për mbështetjen financiare për fëmijën që merrni direkt nga prindi jokujdestar, ndërsa po merrni ndihmë ekonomike, duhet të dorëzohet te HRA-ja. Mbajtja e këtyre pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën konsiderohet mashtrim mirëqenieje.
- Nëse shumica e marrë e mbështetjes financiare për fëmijën është më e madhe se përfitimet tuaja, mund të jeni në gjendje të mbyllni çështjen tuaj të ndihmës ekonomike dhe të keni ende të drejtën për të përfituar nga SNAP (ndihma ushqimore), Krediti i Tatimit mbi të Ardhurat e Fituar (EITC), mbështetja financiare për fëmijën dhe përfitimet nga Medicaid.

MARRJA E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN KUR SHKËPUTENI NGA NDIHMË EKONOMIKE

- Pasi të mos merrni më ndihmë ekonomike ose vetëm ndihmë mjekësore (MAO), do t'ju dërgohen të gjitha pagesat nga prindi jokujdestar për mbështetjen aktuale financiare për fëmijën. Ne do të vazhdojmë të sigurohemi që pagesat janë bërë rregullisht dhe në kohë, pa kosto për ju.
- Në disa raste, OCSS-ja do të ketë të drejtë të mbajë pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën nga koha kur familja juaj merrte ndihmë ekonomike. Kjo do të ndodhë vetëm kur ju të keni marrë çdo pagesë që ju është detyruar në bazë të urdhrit të mbështetjes financiare për fëmijën ose kur të ardhurat merren duke penguar rimbursimet e taksave mbi të ardhurat shtetërore ose federale.
- Nëse nuk keni pasur një urdhër për mbështetje financiare për fëmijën gjatë kohës që keni marrë ndihmë ekonomike por tani keni informacion që do të na ndihmojë ne të marrim mbështetje financiare për fëmijën për familjen tuaj, na njoftoni menjëherë duke telefonuar në numrin 888-208-4485 për linjën e ndihmës së Mbështetjes Financiare për Fëmijën në shtetin e Nju Jorkut. Nëse ne jemi në gjendje të gjejmë vendndodhjen e prindit jokujdestar, do t'ju kontaktojmë në mënyrë që të mund të bëni një kërkesë në Gjykatën e Çështjeve Familjare për të marrë një urdhër.

Pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën përveç punës dhe mbështetjeve të tjera si Krediti i Tatimit mbi të Ardhurat e Fituar (EITC), Programi për Ndihmën Ushqimore Suplementare (SNAP, e quajtur ndihma ushqimore), Medicaid, kujdesi i subvencionuar për fëmijët – mund t'ju ndihmojnë të bëheni financiarisht të pavarur dhe të mbështesni familjen tuaj.

INFORMACIONI I KONTAKTIT I MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Nëse keni pyetje rreth programit të mbështetjes financiare për fëmijën, keni nevojë për ndihmë me çështjen tuaj të mbështetjes financiare për fëmijën ose duhet t'i jepni informacion shtesë OCSS-së si p.sh. ndryshimi i vendit të punës ose i adresës:



Dërgojini një email Shërbimit ndaj Klientit të Zyrës së HRA-së për Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us.

Përfshini emrin tuaj të plotë, ID-në e çështjes së mbështetjes financiare për fëmijën dhe datëlindjen. Vendosni një frazë përshkuese të subjektit dhe jepni detaje në emailin tuaj, në mënyrë që stafi t'ju japë një përgjigje të detajuar.



Për të lënë një takim telefonik me një përfaqësues të Shërbimit ndaj Klientit, na dërgoni email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us.

Jepni emrin tuaj të plotë, numrin e çështjes së mbështetjes financiare për fëmijën, datëlindjen, një përshkrim të shqetësimit (-ve), numrin e telefonit dhe orarin kur preferoni t'ju kontaktojmë. Përdorni subjektin "Kërkesë për takim me Shërbimin ndaj Klientit" në emailin tuaj. Kërkesat e takimeve telefonike do të marrin përgjigje brenda 3 ditësh pune.



Vizitoni Qendrën Fizike të OCSS-së së HRA-së për Shërbimin ndaj Klientit ose një Gjykatë për Çështjet Familjare. Vendndodhjet mund të gjenden në adresën <https://on.nyc.gov/contactocss>.



Vizitoni faqen e internetit të OCSS-së së HRA-së në adresën <https://nyc.gov/hra/ocss> për të mësuar më shumë rreth shërbimeve të mbështetjes financiare për fëmijën.



Telefononi Linjën Telefonike të Ndhmës për Mbështetjen Financiare për Fëmijën në shtetin e Nju-Jorkut në numrin 888-208-4485.



Dërgojini korrespondencat postare në adresën:
OCSS
PO Box 830
Canal Street Station
New York, NY 10013

BURIMET NË INTERNET

Zyra për Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën në qytetin e Nju-Jorkut (The New York City Office of Child Support Services) (OCSS)
nyc.gov/hra/ocss

Shikoni video të mbështetjes financiare për fëmijën
youtube.com/hranyc

Zyra e Fuqizimit Financiar e qytetit të Nju-Jorkut (New York City Office of Financial Empowerment)
Këshillim dhe edukim financiar pa pagesë
nyc.gov/ofe

Spektori për Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën në shtetin e Nju Jorkut (New York State Division of Child Support Services),
Shikoni informacionin e llogarisë tuaj*
childsupport.ny.gov

Sistemi i Unifikuar i Gjykatave në shtetin e Nju-Jorkut (New York State Unified Court System)
nycourts.gov

Aplikacioni celular për mbështetjen financiare për fëmijën NYC Access HRA
<http://www.nyc.gov/childsupportmobile>

SHABLLON I URDHRI TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Çështja numër: F-XXXX-XX

PJESA A

F.C.A. §§ 413, 416, 433, 438, 439, 440, 442-447, 471; Neni.5-B, Ligjet për Gjykatën e Çështjeve Familjare që rregullojnë seancën gjyqësore

4-7 11/2002 Numri i formularit dhe data e lëshimit

Në një mandat të Gjykatës së Çështjeve Familjare të shtetit të Nju Jorkut, mbajtur në dhe për Qarkun e Richmond, në 100 Richmond Terrace, Staten Island, NY 10301, më 4 tetor, 2004

Adresa e gjykatës dhe data e seancës

PJESA B

TË PRANISHËM Magjistrati mbështetës i Gjykatës për Çështjet Familjare Për çështjen e një procesi mbështetës

SSN-ja e prindit kujdestar: XXX-XX-XXXX, Padihtësi, – kundër – SSN-ja e prindit jokujdestar: XXX-XX-XXXX, I padituri.

Dozja #: XXXXX
Numri i çështjes #: F-XXXX-XX
CSMS #: XXXXXXXXX

Informacion për çështjen e mbështetjes financiare për fëmijën dhe identifikimin në gjykatë

URDHËR MBËSHTETJE

Loji i urdhrit

Palët e përfshira

PJESA C

KUJDES: MOSRESPEKTIMI I KËTJË URDHRI NË MËNYRË TË QËLLIMSHME MUND TË REZULTOJË NË BURGIM PËR MOSMBËSHTETJE OSE SHPËRFILLJE KRIMINALE. MOSRESPEKTIMI I KËTJË URDHRI MUND TË REZULTOJË NË PEZULLIM TË LEJES SUAJ TË DREJTIMIT, LICENCAVE PROFESIONALE TË LËSHUARA NGA SHTETIT, TË TREGTISË, BIZNESIT DHE ATYRE PROFESIONALE, SI DHE LICENCAVE DHE LEJEVE REKREACIONALE DHE SPORTIVE DHE KONFISKIM TË PRONËS SË PATUNDSHME DHE PERSONALE.

Paraqitja e një kundërshtimi

KUNDËRSHTIMET SPECIFIKE ME SHKRIM NDAJ KËTJË URDHRI MUND TË DORËZOHEN NË GJYKATË BRENDAS 30 DITËSH NGA DATA E MARRJES SË URDHRI NË GJYKATË OSE ME ANË TË SHËRBIMIT PERSONAL, OSE BRENDAS 35 DITËSH NGA DATA E DËRGIMIT NËSE URDHRI ËSHTË DËRGUAR ME POSTË.

Padihtësi i lartpërmendur ka paraqitur një kërkesë në këtë Gjykatë më 22 qershor 2004, duke pretenduar se **prindi jokujdestar** duhet të paguajë mbështetje për:

Emri Datëlindja
Emri i fëmijës XX/XX/XXXX

Prindi jokujdestar, pasi është këshilluar nga gjykata për të drejtën për avokat, është paraqitur para kësaj gjykate për t'iu përgjigjur kërkesës dhe për të treguar se përse nuk duhet të jepet një urdhër mbështetjeje dhe lehtësime të tjera të përfshira në kërkesë; dhe **Prindi jokujdestar** ka pranuar pretendimet e kërkesës; dhe çështja ka ardhur për shqyrtim në këtë gjykatë;

PJESA D

TANI, pas shqyrtimit dhe hetimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes dhe pasi dëgjimit të provave dhe dëshmiave të ofruara në lidhje me të, gjykata konstaton se: **Prindi jokujdestar** është pala jokujdestare, shuma javore përkatese e detyrimit të mbështetjes financiare bazë e së cilës është XX.XX\$ për fëmijën me të dhënat e mëposhtme:

Emri i fëmijës Datëlindja Numri i sigurimeve shoqërore #

Gjykata gjithashtu konstaton se: Shuma përkatese e detyrimit të mbështetjes financiare bazë të prindit jokujdestar nuk është as e padrejtë dhe as e papërshtatshme;

Pala jokujdestare momentalisht nuk është e punësuar; **Statusi i punësimit të prindit jokujdestar** TANI, pas shqyrtimit dhe hetimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes dhe pasi dëgjimit të provave dhe dëshmiave të ofruara në lidhje me të,

PJESA E

URDHËROHET DHE VENDOSËT duke filluar nga data 28 janar 2005, **prindi jokujdestar** është ngarkuar me detyrimin për të mbështetur personin e mëposhtëm dhe ka mjetet e mjaftueshme dhe është në gjendje të fitojë këto mjete për t'i paguar shumën XX.XX\$ çdo javë **Prindit jokujdestar** me çek të certifikuar ose urdhër pagese që i dorëzohen Njesisë për Marrjen e Mbështetjes, këto pagesa duhet të fillojnë në datën 28 janar 2005, për fëmijët e **prindit jokujdestar** të ndara si në vijim:

Data e hyrjes në fuqi të urdhrit të mbështetjes financiare për fëmijën (Data juaj do të jetë e ndryshme)

Personi do të marrë pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën

4 - 7 Emri Numri i sigurimeve shoqërore Datëlindja Shuma

Fëmijë XX/XX/XXXX

Fëmija Mbështetja financiare totale për fëmijën: XX.XX\$ në javë

PJESA E vazhdon

URDHËROHET që paguesi, pala kujdestare dhe çdo palë tjetër individuale të njoftojnë menjëherë Njesisë e Marrjes së Mbështetjes për çdo ndryshim në informacionin e mëposhtëm: adresat e banimit dhe postare, numrin e sigurimeve shoqërore, numrin e telefonit, numrin e lejes së drejtimit; dhe emrin, adresën dhe numrat e telefonit të punëdhënësve të palëve dhe çdo ndryshim në përfitimet e sigurimit shëndetësor, duke përfshirë çdo ndërprerje të përfitimeve, ndryshim në kompaninë ose shumën e paguar për sigurimin shëndetësor, ose në sasinë dhe disponueshmërinë e përfitimeve ekzistuese ose të reja; gjithashtu

URDHËROHET që ky urdhër ekzekutohet në përputhje me nenin 5241 ose 5242 të Ligjit dhe Rregullave të Praktikës Civile, ose në çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj; si dhe

URDHËROHET që **prindi jokujdestar** të paguajë shpenzimet shtesë si në vijim:

Shpenzimi/Paguesi	Pagesë	E pagueshme
Pa rimbursim shëndetësor/ Prindi kujdestar	XX %	Nëpërmjet SCU-së
Kujdesi për fëmijën		
Prindi kujdestar	XX %	Direkt

SHpenzime përveç shumës bazë të mbështetjes financiare për fëmijën

- Mjekësore
- Kujdesi për fëmijën
- Arsimi

PJESA F

GJITHASHTU URDHËROHET që të gjitha pagesat që paguhen nëpërmjet Njesisë për Mbledhjen e Mbështetjes duhet të dërgohen me postë të: Njësia për Marrjen e Mbështetjes, Kutia postare 15363, Albany, NY 12212- 5363;

PJESA G

SË FUNDMI URDHËROHET që të jepet një kopje e këtij urdhri nga Njësia për Marrjen e Mbështetjes për Regjistrin e Çështjeve të Urdhrave të Mbështetjes në Shtetin e Nju Jorkut të krijuar në zbatim të seksionit 111-b(4-a) të ligjit për Shërbimet Sociale; si dhe URDHËROHET që ky është një urdhër mbështetjeje në shumën XX\$ në javë nga data 8/10/04 derisa të rritet më 28/01/05

PJESA G

SHËNIM: (1) KY URDHËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR FËMIJËN DO TË NDRYSHOHET NËPËRMJET APLIKIMIT TË NDRYSHIMIT TË KOSTOS SË JETESËS NGA NJËSIA E MARRJES SË MBËSHTETJES JO MË PARË SE NJËZET E KATËR MUAJ PAS LËSHIMIT, MODIFIKIMIT OSE RREGULLIMIT TË FUNDIT TË URDHRI, ME KËRKESË TË NJËRËS NGA PALËT ME URDHËR OSE SIPAS PARAGRAFIT TË MËPOSHTËM (2). PAS APLIKIMIT TË NJË NDRYSHIMI TË KOSTOS SË JETESËS ME UDHËZIM TË NJËSISË PËR MARRJEN E MBËSHTETJES, DUHET TË DËRGOHET NJË KOPIJE E URDHRI TË NDRYSHUAR TË PALËT TË CILAT, NËSE KUNDËRSHTOJNË NDRYSHIMIN E KOSTOS SË JETESËS, DO TË KENË 35 DITË NGA DATA E DËRGIMIT ME POSTË PËR TË DORËZUAR NJË KUNDËRSHTIM ME SHKRIM NË GJYKATË PËR KËTË URDHËR TË NDRYSHUAR. PAS MARRJES SË KËTJË KUNDËRSHTIMI ME SHKRIM, GJYKATA DUHET TË PLANIFIKOJË NJË SEANCË GJYQËSORE NË TË CILËN PALËT MUND TË JENË TË PRANISHME PËR TË OFRUAR PROVA QË DO TË MERREN PARASYSH NGA GJYKATA PËR NDRYSHIMIN E URDHRI TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN NË PËRPUTHJE ME STANDARDET E LIGJIT PËR MBROJTJEN PËR FËMIJËN.

(2) NJË MARRËS I NDIHMËS FAMILJARE DUHET TË RISHIKOJË DHE NDRYSHOJË URDHRI E MBËSHTETJES PËR FËMIJËN NËN DREJTIMITIN E NJËSISË PËR MARRJEN E MBËSHTETJES JO MË HERËT SE NJËZET E KATËR MUAJ PAS LËSHIMIT TË KËTJË URDHRI, MODIFIKIMIT OSE RREGULLIMIT TË TIJ TË FUNDIT PA APLIKIM TË MËTEJSHËM TË NDOJË PALË. TË GJITHA PALËT DO TË NJOFTOHEN PËR NDRYSHIMET.

(3) KUR NJËRA PALË NUK ËSHTË NË GJENDJE TË JAPË NJË ADRESË AKTUALE KU MUND TË DËRGOHET URDHRI I NDRYSHUAR, DHE TË PËRDITËSOJË NDRYSHIMET, NË NJËSINË E MARRJES SË MBËSHTETJES, SIÇ KËRROHET NGA SEKSIONI 443 NË LIGJIN PËR GJYKATËN E ÇËSHTJEVE FAMILJARE, SHUMA E DETYRIMIT TË MBËSHTETJES NË TË DUHET TË BËHET E DETYRUESHME NË DATËN E AFATIT PËR PAGESËN E PARË SIPAS KUSHTEVE TË URDHRI PËR MBËSHTETJË TË RISHIKUAR DHE NDRYSHUAR NË OSE PAS DATËS E FAKTIVE TË URDHRI PAVARËSISHT NËSE PALA KA MARRË NJË KOPIJE TË URDHRI TË NDRYSHUAR OSE JO.

Datë: 4 tetor, 2004 **VENDOSNI**

Magjistrati mbështetës i Gjykatës së Çështjeve Familjare

Plotësoni kutinë që aplikohet për ju:

Urdhri është dërguar me postë më [specifikoni datën (-at) dhe personin të cilit i është dërguar];

Emri dhe vula e magjistratit mbështetës

FJALORTH PËR TERMAT E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

A

ANALIZË ADN-je: Analizë e faktorëve trashëgues që përcakton nëse një burrë i caktuar është babai i fëmijës; kampionet e ADN-së merren në pjesën e brendshme të faqes së babait, nënës dhe fëmijës duke përdorur një tampon të veçantë.

ANGAZHIM NË PARA: Si rezultat i një seance gjyqësore, një prind jokujdestar mund të urdhërohet t'i paguajë Njësisë për Marrjen e Mbështetjes në OCSS një angazhim në para në shumën e pagesës së mbështetjes financiare për fëmijën së deri tre viteve. Pagesat mund të merren nga kjo depozitë nëse prindi jokujdestar nuk e paguan rregullisht mbështetjen.

ARSYE E PRANUESHME PËR PËRJASHTIM: Arsyë ligjore për të cilën një aplikant ose marrës i ndihmës ekonomike përjashtohet nga detyrimi për të bashkëpunuar me mbështetjen financiare për fëmijën.

ATËSIA OSE PËRCAKTIMI I ATËSISË/MËMËSISË: Përcaktimi ligjor i atësisë. Përcaktimi i atësisë ose atësisë/mëmësisë duhet të bëhet përpara lëshimit të urdhrit të mbështetjes financiare ose mjekësore për fëmijën.

B

BABAI LIGJOR: Personi që njihet me ligj si prindi mashkull i fëmijës. Për t'u njohur si babai ligjor, duhet të përcaktohet atësia/mëmësia nëse prindërit nuk janë të martuar me njëri-tjetrin.

BARRA E PROVËS: Detyra e një pale për të paraqitur pjesën më të madhe të provave në një pikë apo çështje.

C

CAKTIMI I TË DREJTAVE TË MBËSHTETJES FINANCIARE: Marrëveshje nga një person për t'i dorëzuar shtetit çdo të drejtë për mbështetje financiare për fëmijën që i jepet gjatë kohës që merr ndihmë ekonomike në shkëmbim të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera.

COLA (Ndryshimi i Kostos së Jetesës): Rritja e urdhrit të mbështetjes financiare për fëmijën, pa seancë gjyqësore. COLA bazohet në ndryshimet e Indeksit të Çmimeve të Konsumit për të gjithë Konsumatorët Urbanë (CPI-U), i cili shikon ndryshimet e shpenzimeve të jetesës së përditshme si ushqimi, veshjet, strehimi, etj.

CPI-U (Indeksi i Çmimeve të Konsumit për të gjithë Konsumatorët Urbanë): Gjurmë çmimet e artikujve për ushqime, veshmbathje dhe strehim mbi baza vjetore. Ndryshimet e kushteve të jetesës (COLA) bazohen në ndryshimet vjetore të CPI-U-së.

D

DEKLARATA FINANCIARE: Dokument që u jepet të dyja palëve në një çështje të mbështetjes financiare për fëmijën, që kërkon informacion të detajuar financiar, të pagës dhe shpenzimeve; përdoret nga gjykata për të përcaktuar mbështetjen financiare për fëmijën, mbështetjen mjekësore, kujdesin ndaj fëmijëve dhe pjesë të tjera të urdhrit të mbështetjes financiare për fëmijën.

DEKLARATË: Deklaratë me shkrim e faktit e bërë në mënyrë të vullnetshme nën betim.

DETYRIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE BAZË PËR FËMIJËN: Shuma e mbështetjes financiare për fëmijën e bazuar në një përqindje fikse të të ardhurave të prindit, para mbështetjes mjekësore dhe shpenzimeve për kujdesin për fëmijën, dhe/ose shpenzimet e arsimit janë të shtuara.

DISBURSIMI: Pagesa e fondeve të mbledhura për mbështetjen financiare për fëmijën për prindërit jokujdestarë ose për Departamentin e Shërbimeve Sociale nëse klienti merr ndihmë ekonomike.

E

EBT (Transferimi Elektronik i Përfitimeve): Metoda që përdor shteti i Nju Jorkut për të dërguar paratë e Ndihmës së Përkohshme dhe të Invaliditetit (OTDA) dhe përfitimet e SNAP-it te marrësit. Përfitimet aksesohen duke përdorur një letërnjoftim dhe një PIN.

EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM: Aplikimi i metodave për të marrë pagesat për një fëmijë ose detyrimet e mbështetjes mjekësore që përmban urdhri i mbështetjes financiare për fëmijën. Disa mënyra janë sekuestrimi i aseteve, pezullimi i lejes së drejtimit, mosdhënia e pasaportës së SHBA-së, etj.

EMANCIPIM: Kur fëmija nuk po jeton me prindërit e tij ose saj dhe ka një burim të ardhurash, është mobilizuar në ushtri ose është martuar.

F

FLETËTHIRRJE: Njoftim se është ndërmarrë një veprim kundrejt marrësit. Një fletëthirrje për një seancë gjyqësore për mbështetje financiare për fëmijën i tregon prindit kur dhe ku duhet të paraqitet dhe çfarë informacioni duhet të marrë me vete.

G

GJETJA E VENDNDODHJES: Proces gjatë të cilit gjendet prindi jokujdestar, me qëllim përcaktimin e atësisë/mëmësisë dhe përcaktimin dhe/ose ekzekutimin e detyrueshëm të mbështetjes financiare për fëmijën.

GJYKIM: Vendim zyrtarë ose konkluzion i një gjyqtari ose magjistrati mbështetës.

H

HEDHJE POSHTË ME TË DREJTË ANKIMIMI: Kërkesa është hedhur poshtë, por mund të paraqitet sërish më vonë në gjykatë. Për shembull, nuk ka shërbim për dërgimin e fletëthirrjes.

HEDHJE POSHTË PA TË DREJTË ANKIMIMI: Faktet e një kërkesë kanë rezultuar të pabaza dhe çështja është hedhur poshtë plotësisht nga gjykata. Për shembull: Analiza e ADN-së tregon që i padituri nuk është babai biologjik.

I

I PADITURI: Personi që i përgjigjet padisë; pala kundër të cilës është ngritur padia.

I PAGUARI: Personi ose organizata në emër të të cilit paguhen paratë e mbështetjes financiare për fëmijën (për shembull, gjyshja).

I VARUR: Një fëmijë që është nën kujdesin e dikujt tjetër. Pjesa më e madhe e fëmijëve që kualifikohen për mbështetje financiare janë të varur.

J

JURIDIKSIONI: Autoriteti ligjor që ka një gjykatë ose agjenci administrative mbi persona të caktuar dhe mbi lloje të caktuara çështjesh, zakonisht në një zonë të caktuar gjeografike.

JURIDIKSION JOEKSKLUZIV: Një urdhër që lejon më shumë se një gjykatë të marrë vendime rreth modifikimit të një urdhri mbështetjeje financiare për fëmijën. Kjo mund të ndodhë me Gjykatën Supreme të shtetit të Nju Jorkut dhe me Gjykatën e Çështjeve Familjare.

JURIDIKSONI I ZGJERUAR: Dispozitë ligjore që lejon një shtet të pretendojë juridiksion personal mbi dikë që jeton në një shtet tjetër.

KËRKESË: Kërkesë zyrtare me shkrim drejtuar një gjykate me anë të së cilës kërkohet veprim nga gjykata.

KËRKESË PËR MODIFIKIM: Kërkesë zyrtare me shkrim drejtuar një gjykate me anë të së cilës kërkohet ndryshim në urdhrin ekzistues të mbështetjes financiare për fëmijën.

KËRKESË PËR PËRCAKTIMIN E ATËSISË (OSE ATËSISË/MËMËSISË): Kërkesë zyrtare me shkrim drejtuar një gjykate me anë të së cilës kërkohet veprim gjyqësor për të përcaktuar atësinë ligjore të një personi të caktuar për një fëmijë të caktuar.

KOMPENSIMI ME ANË TË RIMBURSIMIT TË TAKSAVE: Procesi me anë të cilit merren rimbursimet e taksave të prindit jokujdestar për të shlyer borxhin e mbështetjes financiare për fëmijën.

KOMPENSIM: Kompensim ligjor.

KONFISKIMI I PRONËS (PEX): Procesi administrativ me anë të të cilit OCSS-ja sekuestron asetet financiare, zakonisht llogaritë bankare, të prindit jokujdestar, i cili nuk ka paguar shumën e mbështetjes financiare për fëmijën.

KONFISKIM: Procedurë gjyqësore me anë të së cilës mbahet një pjesë e pagës dhe/ose asetëve të një personi për të paguar një borxh siç mund të jetë mbështetja financiare për fëmijën.

KUJDESTARI: Vendim ligjor që përcakton me kë duhet të jetojë fëmija: nënën, babin ose një të rritur tjetër.

KUNDËRSHTIM: Pretendim me shkrim që kundërshton pika të caktuara në një urdhër. Duhet të dorëzohet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së urdhrit.

L

LIGJI I STANDARDEVE PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR FËMIJËN (CSSA): Legjislacion i miratuar në vitin 1989 për t'i bërë urdhrat e mbështetjes financiare për fëmijën të drejta dhe të konsistente në të gjithë shtetin e Nju Jorkut, duke standardizuar formulën për llogaritjen e urdhrave bazë të mbështetjes financiare për fëmijën.

LIGJI PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË FAMILJES: Ligji i miratuar në vitin 1988 që kërkon mbajtje të menjëhershme nga paga të urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën dhe u kërkon shteteve të përdorin udhëzime për të vendosur shumën e mbështetjes financiare për çdo familje.

LIGJI PËR MBROJTJEN E KREDITIT TË KONSUMATORIT (CCPA): Ligji federal që kufizon shumën që mund të mbahet nga të ardhurat; merr në konsideratë të ardhurat neto pas heqjes së taksave të detyrueshme, shumën e detyrimeve të prapambetura dhe nëse një familje tjetër po mbështetet financiarisht.

M

MAGJISTRATI MBËSHETËS: Juristi i caktuar nga Gjykata e Çështjeve Familjare lokale, i cili mund të dëgjojë dëshmitë dhe të marrë vendime për çështjet e mbështetjes financiare për fëmijën.

MARRËSI: Person ose organizatë që merr fonde mbështetëse dhe/ose përfitime nga ndihma publike, duke përfshirë ndihmë ekonomike, SNAP (ndihma ushqimore), Medicaid, etj.

MARRËVESHJE: Marrëveshje me shkrim nga palët e anëve të ndryshme të një çështjeje.

MBAJTJA E PAGËS: Zbritje automatike nga të ardhurat që fillon sapo urdhri për zbritjen nga të ardhurat i dërgohet punëdhënësit.

MBËSHETJA ME EFEKT PRAPAVEPRUES: Mbështetje financiare për fëmijën që është urdhëruar të paguhet për një periudhë kohore të kaluar, zakonisht datën kur është bërë kërkesa. Mbështetja me efekt prapaveprues krijon një borxh të menjëhershëm.

MBËSHETJE E TEPËRT: Kur shumica e të ardhurave nga mbështetja financiare për fëmijën është më e madhe se shumica e përfitimeve nga ndihma ekonomike e marrë nga klienti.

MBËSHETJE MJEKËSORE: Dispozitë ligjore që parashikon përfshirjen e mbulimit mjekësor në urdhrin e mbështetjes financiare për fëmijën.

MOSPAGESË E QËLLIMSHME: Prindi jokujdestar nuk paguan qëllimisht mbështetjen financiare për fëmijën të urdhëruar nga gjykata edhe pse ai/ ajo e ka mundësinë për ta paguar.

N

NDIHMË EKONOMIKE: Përfitim nga qeveria që ofron mbështetje financiare për individët dhe familjet me të ardhura shumë të ulëta, që administrohet në qytetin e Nju Jorkut nga HRA (Administrata e Burimeve Njerëzore). Ndihma ekonomike i jepet klientëve elektronikisht me anë të EBT-së (Transferimi Elektronik i Përfitimeve).

NDRYSHIMI I RRETHANAVE: Ndryshim i papritur në situatën financiare të prindit jokujdestar për shkak të lëndimit, sëmundjes ose humbjes së papritur të punësimit që ndikon në aftësinë e tyre për të paguar mbështetjen financiare për fëmijën të urdhëruar nga gjykata; arsye për kërkimin e një modifikimi për uljen e shumës në gjykatë. Duhet të kenë kaluar tre vjet që nga përcaktimi ose modifikimi i fundit i urdhrit dhe duhet të ketë të paktën 15% ndryshim në të ardhura.

NDRYSHIMI I TË PAGUARIT: Mundëson që pagesat private të mbështetjes financiare për fëmijën t'i dërgohen OCSS-së për përpunim, për ruajtje të dhënash, shpërndarje dhe ekzekutim të detyrueshëm.

NDRYSHIM: Ndryshim në një dokument ligjor.

NGRIRJA E PRONËS: Ngrirja e pronës për të parandaluar shitjen ose transferimin derisa të shlyhet borxhi.

NIVELI I VARFËRISË: Niveli i të ardhurave që konsiderohet shumë i ulët për të plotësuar nevojat bazë të jetës sipas qeverisë federale. Niveli i varfërisë në vitin 2021 për një person ishte 12,880\$. Për çdo person të shtuar në familje, shtohen 4,540\$. Udhëzimet për varfërinë publikohen çdo vit nga Departamenti Amerikan i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore në adresën [aspe.hhs.gov/poverty-guidelines](https://www.hhs.gov/poverty-guidelines).

NOTERIZIM: Certifikimi i diçkaje, si për shembull një nënshkrimi, në një dokument ligjor, si autentik ose legjitim duke vendosur një vulë dhe nënshkrim.

NUMRI I ÇËSHTJES: Numri i përcaktuar nga gjykata për të identifikuar çështjen.

NUNC PRO TUNC: Përkthimi në latinisht i shprehjes 'tani për atëherë' - i referohet ndryshimit të datës së një urdhri, gjykimi, ose dorëzimi të një dokumenti, në një datë më të hershme.

NJËSIA E MARRJES SË MBËSHETJES (SCU): Sektori i Zyrës së Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën përgjegjës për mbledhjen, monitorimin dhe shpërndarjen e pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën.

NJOFTIM PËR NDIHMË MJEKËSORE KOMBËTARE (NMSN): Njoftim që i dërgohet punëdhënësit të prindit jokujdestar kur kërkohet që të mbulohet sigurimi shëndetësor kur të jetë i disponueshëm.

NJOHJA E ATËSISË/MËMËSISË (AOP): Formular që përcakton atësinë/mëmësinë (babain ligjor) të një fëmije përmes një procesi të vullnetshëm, pa shkuar në gjykatë. Duhet të plotësohet dhe nënshkruhet nga të dy prindërit.

P

PADITËSI: Personi ose organizata që paraqet një kërkesë zyrtare për të nisur një veprim nga gjykata.

PAGESAT E AKUMULUARA: Shumica e pagesave të papaguara të mbështetjes financiare për fëmijën.

PAGESA TË PRAPAMBETURA: Shumë mbështetjeje financiare për fëmijën që i ka kaluar afati dhe nuk është paguar.

PAGESA TRANZITORE: Marrësit e ndihmës ekonomike me urdhra mbështetjeje financiare për fëmijën mund të marrin deri në 100\$ në muaj (ose 200\$ për dy ose më shumë fëmijë që marrin mbështetje financiare) nga mbështetja e mbledhur brenda muajit; e quajtur gjithashtu edhe pagesë bonus.

PAGESË BONUS: Marrësit e ndihmës ekonomike me urdhra mbështetjeje financiare për fëmijën mund të marrin deri në 100\$ në muaj (200\$ për dy ose më shumë fëmijë që marrin mbështetje financiare për fëmijën) nga mbështetja e mbledhur brenda muajit. (Shihni edhe Pagesën Tranzitore).

PAGUESI: Personi që bën një pagesë, zakonisht prindi jokujdestar ose dikush që vepron për llogari të tij/saj. Njihet edhe si obliguesi.

PALA: Personi ose organizata e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në një çështje ligjore.

PENGIMI I FITIMEVE TË LOTARISË: Procesi me anë të të cilit fitimet e çmimeve të lotarisë së prindit jokujdestar dërgohen në Zyrën e Ekzekutimit të Detyrueshëm të Mbështetjes Financiare për Fëmijën për të shlyer detyrimet e pagesave të vonuara.

PENGIMI: Metodë për të siguruar mbështetjen financiare për fëmijën duke marrë një pjesë të pagesave jo nga paga që merr prindi jokujdestar. Pagesat jo nga paga që pengohen përfshijnë rimbursimet e taksave dhe fitimet nga lotaritë.

PËRCAKTIMI: Procesi i vërtetimit të atësisë/mëmësisë dhe/ose marrja e një urdhri gjykatë për të përcaktuar një mbështetje financiare për fëmijën.

PËRFUNDIMET PËR FAKTET E PARAQITURA: Shënime dhe llogaritje që përdoren nga magjistrati mbështetës për të përcaktuar një urdhër mbështetjeje financiare për fëmijën.

PËRFUNDIMI I NJË URDHRI: Përfundimi i detyrimit aktual; siguroni datën efektive të përfundimit të një urdhri mbështetjeje financiare për fëmijën. Megjithatë pagesat e prapambetura duhet të paguhën.

PIN (Numri Personal i Identifikimit): Numër unik identifikimi i klientëve që përdoret për të aksesuar informacionin e llogarisë së tyre të mbështetjes financiare për fëmijën nga faqja e internetit të shtetit të Nju Jorkut për mbështetjen financiare për fëmijën (childsupport.ny.gov) dhe nga linja telefonike e ndihmës (888-208-4485).

PRINDI KUJDESTAR (CP): Prindi, i afërmi ose kujdestari që jeton me fëmijën ose fëmijët dhe është kujdestari parësor i tij/tyre.

PRIND JO I PRANISHËM: Person që nuk është i pranishëm në shtëpi dhe është përgjegjës ligjërish për dhënien e mbështetjes financiare për një fëmijë të varur (referuar gjithashtu si prindi jokujdestar, prindi që nuk banon me fëmijën, dhe i padituri në një çështje në gjykatë).

PRIND JOKUJDESTAR (NCP): Prindi që nuk jeton me të miturin dhe nuk është kujdestari parësor i tij.

PROCES ADMINISTRATIV: Metodot me anë të të cilave OCSS-ja realizon ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrave të mbështetjes pa iu drejtuar gjykatës dhe gjyqtarëve.

PRO SE: Përkthimi në latinisht i shprehjes “për veten”; dikush që përfaqëson veten në gjykatë pa avokat.

QENDËR PUNE: Pika e hyrjes për personat që kërkojnë ndihmë ekonomike. Ofron një pikë aksesimi për të kërkuar punë, trajnime, dhe marrjen e përfitimeve si Medicaid dhe SNAP, ose ndihmave ushqimore. OCSS-ja merr referimeve nga qendrat e punës për klientët të cilëve u kërkohet të bashkëpunojnë me programin e mbështetjes financiare për fëmijën.

R

RAPORTIMI I PUNËSIMEVE TË REJA: Program që u kërkon të gjithë punëdhënësve të raportojnë punonjësit e rinj në Drejtorinë e Punësimeve të Reja të shtetit të Nju Jorkut për ekzekutimin e mundshëm të detyrueshëm të mbështetjes financiare dhe mjekësore për fëmijën nga zbritjet prej pagave.

RASTET NDËRSHTETËRORE: Rastet kur fëmija i varur dhe prindi jokujdestar jetojnë në shtete të ndryshme dhe kur dy shtete përfshihen në aktivitete të çështjes së mbështetjes financiare për fëmijën, si përcaktimi ose ekzekutimi i detyrueshëm.

RECIPROCITET: Marrëdhënie në të cilën një shtet ose vend u jep disa privilegje shteteve ose vendeve të tjera me kusht që ata të marrin të njëjtin privilegj.

REGJISTRI I ATËSISË (PFR): Të dhënat e atësisë të mbajtura nga shteti i Nju Jorkut. Shembuj të dokumenteve që ruhen në PFR janë formularët për njohjen e atësisë/mëmësisë (AOP), urdhrat e gjykatës që përcaktojnë atësinë/mëmësinë, dhe deklaratat joligjore që lidhen me përcaktimin e atësisë/mëmësisë. PFR-ja mund të konsultohet për çështjet që lidhen me trashëgiminë, birësimin dhe çdo çështje tjetër që kërkon njoftimin e babait të fëmijës.

REZERVA E VETËMBËSHETJES: Faktor në llogaritjen e mbështetjes financiare për fëmijën në shtetin e Nju Jorkut kur njëri prej prindërve është në ose afër nivelit të varfërisë; rezerva e vetëmbështetjes është 135% e nivelit federal të varfërisë. Rezerva e vetëmbështetjes për vitin 2021 ishte 17,388\$.

S

SANKSION: Për klientët që marrin ndihmë, të cilëve u kërkohet të respektojnë mbështetjen financiare për fëmijën. Nëse një klient e respekton atë, përfitimet e ndihmës ekonomike, duke përfshirë përfitimet e qirasë, mund të reduktohen ose ndërpriten. Klientët nuk do të mund të marrin ose vazhdojnë të marrin ndihmë mjekësore për veten dhe nuk do të kualifikohen për të marrë ndihmë nga një Program ndihme për qiramarrje.

SEANCË GJYQËSORE: Procedurë ligjore që zhvillohet në prani të gjyqtarit. Gjyqtari në një seancë gjyqësore të mbështetjes financiare për fëmijën quhet Magjistrat mbështetës.

STEP (Programi i mbështetjes përmes punësimit): Ofron trajnime pune dhe punësim për prindërit jokujdestarë që nuk kanë mundësi të paguajnë mbështetjen financiare për fëmijën pasi nuk janë të punësuar ose kanë punë me pagë të ulët. Në seancën gjyqësore të mbështetjes financiare për fëmijën mund të bëhen referime për në STEP.

SHËRBIMET E GJETJES SË VENDNDODHJES SË PRINDIT: Rrjeti i kompjuterizuar i bazave të të dhënave shtetërore që përdoret për të gjetur të anketuarit në çështjet e mbështetjes financiare për fëmijën.

Shërbimet e Mbështetjes së Gjykatës së Çështjeve Familjare (FCSS): Sektori i OCSS-së që merret me çështjet vendase të mbështetjes financiare për fëmijën që nuk marrin ndihmë ekonomike.

SHËRBIMI FEDERAL I GJETJES SË VENDNDODHJES SË PRINDIT (FPLS): Shërbimi i kompjuterizuar i rrjetit kombëtar të vendndodhjes që ndihmon shtetet të gjejnë prindërit jokujdestar duke përfshirë informacionin e bazës së të dhënave; FPLS-ja mund të ofrojë informacione të dobishme për përcaktimin e kujdestarisë, atësisë/mëmësisë dhe mbështetjes financiare për fëmijën dhe për çështjet e birësimit dhe kujdestarisë.

SHFUQIZIMI I NJË URDHRI: Heqja e një urdhri të mëparshëm, si të mos kishte ekzistuar.

SHQYRTIM DOKUMENTACIONI: Një shqyrtim i kërkuar nga prindi kujdestar që merr ndihmë ekonomike për t'u siguruar që shuma e pagesave tranzitore është e saktë.

SHTYRJA: Shtyrja e përkohshme e një seance gjyqësore deri në një datë specifike në të ardhmen.

SHUMA E DETYRIMIT: Shuma që i kërkohet të paguajë prindit jokujdestar si mbështetje financiare për fëmijën.

SHUMA E PARAVE E PËRCAKTUAR NGA GJYKATA: Shuma specifike e detyrimeve të prapambetura të përcaktuara nga magjistrati mbështetës në një vendim zyrtar, i cili përllogarit me 9% interes në vit. Kërkesa për përcaktimin e shumës së parave mund të bëhet edhe pranë zyrës së Nëpunësit të Qarkut.

SHUMA PËRKATËSE: Pjesa e shumës totale që duhet të paguajë secili prind për pikat e përfshira në urdhrin e mbështetjes financiare për fëmijën, si p.sh. kujdesi për fëmijën ose shpenzimet mjekësore pa rimbursim.

SHUMA SHITESË (E quajtur gjithashtu shuma e shtuar): Shuma që do të paguhet nga zbritja prej të ardhurave përveç detyrimit të zakonshëm të mbështetjes financiare për fëmijën për të plotësuar shumën e papaguar në një llogari.

SHUMË E PAPAGUAR: Një shumë parash që duhet të paguhet në një çështje mbështetje financiare për fëmijën, por nuk është paguar.

T

TË ARDHURA: Çdo formë e rregullt pagese për një individ, pavarësisht nga burimi, duke përfshirë pagat, komisionet, shpërblimet, sigurimin e papunësisë, kompensimin e punonjësit, invaliditetit, pensionin ose interesin. Ndiha ekonomike dhe përfitimet nga SSI-ja nuk konsiderohen të ardhura.

TË ARDHURA TË DISPONUESHME: Shuma e të ardhurave të mbetura pas taksave dhe Medicare, FICA dhe zbritjet e pagesës së planit të pensionit nuk llogariten.

U

UIFSA (Ligji uniform ndërshtetëror për mbështetjen financiare të familjes): Ligj federal i miratuar në vitin 1996 për të lehtësuar procesin e marrjes së pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën në të gjithë shtetet. Ai kërkon që shtetet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të marrë dhe ekzekutuar urdhrat e mbështetjes financiare për fëmijën; i lejon shtetet të miratojnë mbajtjen e drejtpërdrejtë të të ardhurave nga punëdhënësit në shtetet e tjera; parandalon lëshimin e urdhrave të shumëfishtë të mbështetjes financiare për fëmijën për të njëjtin rast në shtete të ndryshme.

URDHËR GJYKATE: Dokument ligjërish detyruet i lëshuar nga një gjykatë. Një urdhër gjykate në lidhje me mbështetjen financiare për fëmijën përcakton sa shpesh, në çfarë shume, për sa kohë dhe çfarë lloj mbështetjeje duhet të paguajë prindi jokujdestar dhe nëse punëdhënësi duhet ta mbajë mbështetjen nga pagat e tij/saj.

URDHËR I DREJTPËRDREJTË PAGESE: Urdhri i mbështetjes financiare për fëmijën paguhet drejtpërdrejt nga prindi jokujdestar për prindin kujdestar.

URDHËR I MBËSHTETJES FINANCIARE: Urdhër i lëshuar nga gjykata që përcakton detyrimin për mbështetje financiare për fëmijën. Urdhrat e mbështetjes mund të jenë të përkohshëm ose përfundimtarë dhe mund të modifikohen dhe ekzekutohen. Urdhrat e mbështetjes financiare mund të përfshijnë mbështetje monetare dhe mjekësore, kujdesin ndaj fëmijës, shpenzimet e arsimit dhe pagesën e detyrimeve të prapambetura, interesat, gjobat dhe forma të tjera lehtësimi.

URDHËR I NJOHJES SË ATËSISË: Urdhër gjykate që përcakton babain ligjor.

URDHËR I VEÇANTË MBËSHTETJEJE FINANCIARE PËR FËMIJËN: Urdhër që i cakton secilës palë të urdhrit (fëmijën, bashkëshortin) një shumë specifike për secilin person të varur.

URDHËR MBROJTJEJE: Direktivë e gjykatës që ndalon kontaktin/komunikim mes palëve.

URDHËR ME PËLQIM NGA TË DYJA PALËT: Urdhër për të cilin kanë rënë dakord të dyja palët. Në një seancë gjyqësore të mbështetjes financiare për fëmijën, prindërit mund të bien dakord për një shumë të ndryshme nga ajo që përcaktojnë udhëzimet në Ligjin për Standardet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën.

URDHËR PËR MBAJTJEN E TË ARDHURAVE (IWO): Procesi administrativ me anë të të cilit pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën të prindit jokujdestar zbriten drejtpërdrejt nga paga ose të ardhurat e tij ose saj dhe dërgohen në Njësinë e Marrjes së Mbështetjes Financiare për Fëmijën. Mund të quhen mbajtje të pagës, konfiskime, ose zbritje nga paga.

URDHËR STANDARD: Urdhër mbështetjeje financiare për fëmijën që jepet kur prindi jokujdestar nuk jep informacion të mjaftueshëm ose nuk paraqitet në gjykatë, kur paraqiten prova për dorëzimin e fletëthirrjes.

URDHËR: Urdhër i shkruar dhe i nënshkruar i një magjistrati mbështetës ose gjyqtari.

V

VENDIM: Vendim juridik i gjykatës.

VETËM NDIHMË MJEKËSORE (MAO), OSE VETËM MEDICAID: Formë ndihme publike që ofron përfitime për përfituesit vetëm në formën e ndihmës mjekësore dhe jo financiare.

W

ZBRITJA NGA TË ARDHURAT (IEX): Procesi administrativ me anë të të cilit pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën të prindit jokujdestar zbriten drejtpërdrejt nga paga ose të ardhurat e tij/saj dhe dërgohen në Njësinë e Marrjes së Mbështetjes Financiare për Fëmijën. Mund të quhen mbajtje të pagës, konfiskime, ose zbritje nga paga.

ZYRA E SHËRBIMEVE TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN: Sektori i Administratës së Burimeve Njerëzore përgjegjës për marrjen dhe ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrave të mbështetjes financiare për fëmijën për familjet që jetojnë në qytetin e Nju Jorkut.



@NYCHRA



NYCHRA



NYCHRA

BK-5 (AL)
(E) Rev. 10/2024

© E drejta e autorit 2024. Qyteti i Nju Jorkut, Administrata e Burimeve Njerëzore/Departamenti i Shërbimeve Sociale Për Leje për të riprodhuar të gjithë ose një pjesë të këtij materiali, kontaktoni Administratën e Burimeve Njerëzore të qytetit të Nju Jorkut.